




UBT NEWS

Gazetë e studentëve të Universitetit për Biznes dhe Teknologji | Maj 2012

POLITICS • ECONOMY • BUSINESS • TECHNOLOGY • EDUCATION • SCIENCE • CULTURE

MANIFESTIM MADHËSHTOR NË 10-VJETORIN E UBT-SË

Në një ceremoni madhështore dhe festive, organizuar në Prishtinë... **Faqe 3**



UBT BASHKËPUNON ME UNIVERSITETIN E UTAH-it NË SHBA

Faqe 2

REICHEL: RRUGA E KOSOVËS PËR NË BE VARET NGA PUNA JUAJ

Ambasadori gjerman në Kosovë, Ernst Reichel zgjodh një debat me studentët e Universitetit për Biznes dhe Teknologji **Faqe 6**

LIMANI: UBT UNIVERSITETI MË PRESTIGJIOZ NË VEND

"UBT-ja dhe njësitë e saja pedagogjike (fakultetet), ofrojnë profesionalizëm, shkencë dhe dituri, e jo diploma fiktive..."

Faqe 12



UBT ANËTARËSON SË SHPEJTI KOSOVËN EDHE NË ORGANIZATËN NDËRKOMBËTARE EUROSIM

Faqe 15



STUDENTËT E UBT-së, AMBASADORË TË DIJES KOSOVARE NË BOTË

Faqe 14-15

"UBT NEWS", PJESË E PANDASHME E ÇDO STUDENTI

"Trajtimi i sferave Politike, Ekonomi, Biznes, Teknologji, Edukim, Shkencë dhe Kulturë e bënë këtë gazetë të një dimensionit dhe niveli shumë të lartë profesionalizmi dhe kredibiliteti. Rubrikat më të pëlqyera dhe nga të cilat opinioni publik në Kosovë, rajon e më gjerë do të përfitonte shumë janë si intervista me profesor e personalitete të ndryshëm, prezantimi i inovacioneve apo hulumtimeve të ndryshme në shkencë dhe sporti vendor"

Faqe 10-11



Editorial



Edmond Hajrizi
President i UBT-së

UNIVERSITETI MODEL

Të jesh institucion privat i arsimit të lartë në Kosovë dhe të kesh prestigjin e institucionit më serioz dhe më të suksesshëm në fushën e kualitetit, është një cilësi që nuk mund të arrihet edhe aq lehtë, duke pasur parasysh një varg rrethanash në të cilat ndodhet shteti, shoqëria po edhe fusha e arsimit në përgjithësi në vendin tonë.

Por, e gjithë kjo nuk është e paarritshme.

Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), në filltet e të cilit startoi furishëm Instituti IEME, e ka plotësuar këtë kriter. Në dhjetëvjetorin e funksionimit të këtyre institucioneve të hulumtimit dhe të shkollimit universitar, ky konstatim, i mbështetur në rezultatet e studentëve dhe, sidomos, në përfundimin e arritur nga ana ekspertëve ndërkombëtarë, dhuratë më të mirë as nuk mund të kishte.

Mësimdhënësit eminentë nga e gjithë bota, për UBT-në kanë qenë dhe janë një realitet. Ata sjellin dijen, kualitetin, kulturën e hulumtimit dhe mësimdhënies në nivele botërore. Krahas tyre, UBT solli programe mësimore bazuar në universitetet më të mira ndërkombëtare. Solli edhe programe novatore, që nuk kanë ekzistuar më parë në vendin tonë. Për t'ua sjellë studentëve kosovarë dijen botërore në Prishtinë, për t'i bindur edhe të tjerët se në Kosovë nuk ka vetëm lajme të këqija, por ka institucione që nuk ngecin aspak me nivel nga simotrat në vendet e zhvilluara.

Të përfaqësosh Kosovën në Projektin Evropian "Erasmus Mundus", të jesh institucioni i parë dhe i vetmi deri tash i certifikuar ndërkombëtarisht me standardin ndërkombëtar për cilësi ISO 9001, ta anëtarësosh dhe ta përfaqësosh Kosovën në Organizatën Botërore për Menaxhimin e Projekteve, ta anëtarësosh dhe ta përfaqësosh Kosovën në Organizatën Evropiane për Cilësi, ta anëtarësosh dhe ta përfaqësosh Kosovën në Organizatën Botërore për Inxhinieri, ta përfaqësosh Kosovën në Programin Evropian për Ndërmarrësi, të organizosh disa herë me radhë në vend konferenca të nivelit shkencor dhe botëror, të zhvillosh Laboratorin modern të Teknologjisë dhe të Robotikës, të zhvillosh institutin e hulumtimeve dhe zhvillimeve zhvillim ekonomik, për ndërmarrësi, teknologji dhe inovacione, të lidësh marrëveshje bashkëpunimi me mbi 60 universitete dhe institucione në botë dhe një lidhje direkte me ekonominë, të aftësosh dhe të certifikosh personat sipas standardeve ndërkombëtare, të organizosh vizita studimore për studentë, institucione dhe biznese, të zhvillosh strategji, projekte dhe hulumtime për institucione dhe sektorë të ndryshëm të shoqërisë, të kesh shkallën më të lartë të punësimit të aluminit, të shënosh numër rekord të transferimeve të studentëve nga universitetet e tjera, të kesh studentë ndërkombëtarë, t'u sigurosh atyre mundësi që një semestër apo një vit të studimeve ta kryejnë jashtë vendit, t'u mundësosh atyre studime master dhe të doktoratës në universitetet partnere, të organizosh dhe të zësh vendin e parë në Kampionatin Evropian të Robotëve që Luajnë Futboll...

Këto janë vetëm disa nga elementet, të përmendura telegrafikisht, që e tregojnë dallimin e UBT-së nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, në vend dhe në rajon.

E bëjnë UBT-në një universitet model, të kërkuar dhe të vlerësuar në planin vendor, konkurrent të dijes dhe të cilësisë në planin ndërkombëtar.

IMPRESUM

UBT News - Gazetë e studentëve të UBT-së,

Editor: Edmond Hajrizi

Kryeredaktore: Naile Demiri

Adresa: www.ubt-uni.net

Tel: 038 541 400

Thyerja Grafike: ELV Studio



10 YEARS

LEADERSHIP and INNOVATION

Education • Research • Training • Consulting
2001/2011



UNIVERSITY EDUCATION
FOR BUSINESS AND TECHNOLOGY
AMERICAN EUROPEAN UNIVERSITY

MANIFESTIM MADHËSHTOR NË 10-VJETORIN E UBT-së



Pamje nga fjalimi i presidentit E. Hajrizi drejtuar të mysafirëve me rastin e 10 vjetorit të themelimit të UBT-së



UBT-ja e nderoi Profesor Peter Kopacek me çmimin "Leadership Excellence Award" për Edukim, Shkencë dhe Teknologji



Në emër të Akademisë Diplomatike te Vjenës, foli Prof. Michel Cullin



Në emër të Akademisë Diplomatike te Vjenës, foli Prof. Ernest Florian Winter



Me rastin e 10 vjetorit të themelimit të UBT-së një fjalim përshëndetës mbajti edhe Rectori i Universitetit të Vlorës, Prof. Dr. Albert Qari



UBT- dha çmime për studentët e dalluar në UBT



UBT-dha çmime për studentët e ambasadorë të UBT-së

Në një ceremoni madhështore dhe festive, organizuar në Prishtinë, Instituti IEME dhe Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) shënuan 10- vjetorin e themelimit dhe të punës së suksesshme.

Themeluesi dhe Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, në një fjalë rasti, vargoi të gjitha të arriturat në rrugën e vështirë, por shumë të suksesshme të rritës dhe të punës së Institutit IEME dhe Universitetit për Biznes dhe Teknologji.

Mjafton vetëm të përmendet faktet në vijim, për të kuptuar rezultatin dhe të arriturat e mëdha të UBT-së.

UBT:
- Përfaqëson Kosovën në Projektin Evropian "Erasmus Mundus",

ku 39 mobilitete janë zhvilluar me universitetet evropiane

- Është institucioni i parë dhe i vetmi deri tash që është certifikuar ndërkombëtarisht me standardin ndërkombëtar për cilësi ISO 9001

- Ka përfaqësuar Kosovën dhe ka zënë vendin e parë në garat e robotikës në Evropë

- E ka anëtarësuar dhe përfaqëson Kosovën në Organizatën Botërore për Menaxhimin e Projekteve

- E ka anëtarësuar dhe përfaqëson Kosovën në Organizatën Evropiane për Cilësi

- E ka anëtarësuar Kosovën dhe e përfaqëson atë në Organizatën Botërore për Inxhinieri

- E përfaqëson Kosovën në Programin Evropian për Ndërmarrësi

- Ka organizuar disa herë me radhë në vend konferenca të nivelit shkencor dhe botëror,

- Ka zhvilluar Laboratorin modern të Teknologjisë dhe të Robotikës

- Ka zhvilluar institutin e hulumtimeve dhe zhvillimeve zhvillim ekonomik, për ndërmarrësi, teknologji dhe inovacione

- Ka marrëveshje bashkëpunimi me mbi 60 universitete dhe institucione në botë dhe një lidhje direkte me ekonominë

- Aftëson dhe certifikon personat sipas standardeve ndërkombëtare

Monografi në 10-vjetorin e UBT-së

E gjithë puna dhjetëvjeçare e IEME-UBT u përfshi në një monografi të botuar nga UBT, e cila është pritur me mjaft interesim.

- Organizon vizita studimore për studentë, institucione dhe biznese

- Zhvilluar strategji, projekte dhe hulumtime për institucione dhe sektorë të ndryshëm të shoqërisë ...

Profesor Peter Kopaček nderohet me çmimin "Leadership Excellence Award"

Profesorin Prof. Dr. Peter Kopaček për kontributin e jashtëzakonshëm që ka dhënë për zhvillimin e UBT-së prej themelimit e deri më sot Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe Këshilli Akademik i UBT-së, si shenjë respekti e nderuan me Çmimin më të lartë që parasheh Stauti i UBT-së, "Leadership Excellence Award"

Studentët e dalluar

Me rastin e 10-vjetorit, UBT dha një varg mirënjohesh. Kështu, me titullin "Student i dalluar" u nderuan:

Nora Hasani
Kaltrina Matoshi
Qendresa Sopaj
Shqiponje Vokshi-Berisha
Gentian Hyseni
Besart Pllana
Ndrim Idrizi
Shpresa Gashi
Delfina Jusufi
Nora Shabani
Lëndita Ibrahim-Osmanaj
Armend Ahmeti
Enver Kurteshi

Ndërsa, me titullin Ambasador i UBT-së u nderuan:

Ardian Stublla
Halil Nallbani
Lirigzona Morina
Saranda Musliu
Arian Agani
Jeton Ibishi
Fidan Bujupi
Agron Krasniqi
Shend Abdullahu
Hana Janjeva
Kreshnik Ismajli
Shefki Svarqa
Ismail Shabani

MENAXHMENTI I UBT-së DHA ÇMIME PËR STAFIN AKADEMIK

Më 13 janar 2012, është mbajtur mbledhja e Këshillit Akademik të UBT-së (Senatit) në të cilën morën pjesë dekanët, prodekanët, kryetaret e këshillave akademike të fakultetit dhe organet tjera akademik në kuadër të UBT-së.

Me këtë rast Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi me theks të veçantë i falënderoi të pranishmit për punën e tyre të palodhshme dhe foli për aktivitete e shumta, sukseset dhe sfidat e UBT-së për vitin që po e lëmë pas.

I pari i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, anëtarët e Këshillit Akademik si dhe profesorët, analizuan dhe shqyrtuan disa çështje më rëndësi për punën dhe zhvillimin e mëtejshëm të Universitetit. Ajo që u theksua si shumë e rëndësishme ishte çështja riakreditimit dhe aplikimit të programeve të reja në Agjencionin e Akreditimit.

“Programet si në Ndërtimtarinë me infrastrukturë, Komunikim, Multimedia dhe Gazetari, Studime evropiane dhe Marrëdhënie ndërkombëtare; Studime



Amerikane dhe Britaneze. Për këto programe kemi bërë analiza dhe kemi marr përvojat nga universitete më prestigjioze dhe kemi krijuar programe me

standarde shumë të larta”, tha Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi.

Menaxhmenti i UBT-së ka analizuar se në UBT do të ketë

më shumë hulumtime dhe publikime shkencore, forume, takime ndërkombëtare, bashkëpunime ndëruniversitare e më gjerë dhe studime të mëtutjeshme.

“UBT, po ashtu unë personalisht jam i përkushtuar që një pjesë të stafit ta regjistroj në studime të mëtutjeshme në nivelin e doktoratës, në ato universitete ndërkombëtare ku UBT ka marrëveshje bashkëpunimi si në Universitetin e Napolit në Republikën e Italisë, në Universitetin City në Angli, në Universitetin e Pillzenit dhe atë të Teknologjisë në Republikën e Çekisë, kurse në Universitetin Teknik të Vjenës disa vetëm kanë diplomuar disa janë në proces dhe vazhdon bashkëpunimi për këtë çështje” citoi Presidenti Hajrizi.

UBT në vitin e kaluar ka korrë mjaftë suksese në përfitim të projekteve nga Komisioni Evropian, po ashtu edhe në këtë vit do aplikojmë me projekte të ndryshme etj.

Për kontributin e stafit akademik që kanë dhënë për zhvillimin dhe ngritjen e cilësisë në UBT, Presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji Prof. Dr. Edmond Hajrizi si shenjë respekti u ndau dhe i nderoi me nga një mirënjohje dhe shtro një drekë.

SARANDA MUSLIU ZGJIDHET KRYETARE E ORGANIZATËS STUDENTORE TË UBT-së



Prishtinë, 17 janar 2011 - Në garë për postin e Kryetarit të Organizatës Studentore të Universitetit për Biznes dhe Teknologji UBT ishin Petrit Reçica, Saranda Musliu, Durim Dabiqaj dhe Alketa Veseli.

Pas votimit nga 22 anëtarëve, komisionit zgjedhor i përbërë nga Petrit Dumnica, Albulena Popaj, Arianit Elshani dhe Fitore Murati dhe dy anëtarët verifikues si Albulena Alimi dhe Arbër Kryeziu, para të pranishmëve në sallë e mbledhjeve po në objektin e Universitetit numëruan votat ku Kryetare e Organizatës Studentore të UBT-së u zgjodh Saranda Musliu kurse nënkryetarë u zgjodh Petrit Reçica dhe Rilind Duriqi dhe Durim Dabiqaj Përfaqësues Ekzekutiv.

Po ashtu Agron Krasniqi, ish kryetar i kësaj organizate para të pranishmëve citoi disa aktivitete të cilat janë realizuara gjatë udhëheqjes së tij si vizita studimore në Republikën e Italisë, në Republikën e Shqipërisë etj.

Po ashtu kryetare e grupeve të studentëve njëkohësisht janë edhe në kryesin Organizatës

Studentore të UBT-së janë si : Filiz Salihu , Herolind Nishefci , Diellza Xhemajli, Bedri Hyseni , Genta Isa, Libert Gashi , Shqiponja Vokshi , Besnik Gashi, Lavdim Mexhixhi, Erkan Ramadani, Durim Dabiqaj , Shkurte Berisha , Besim Shala ; Kreshnik Ismajli ; Besarta Demiraj; Muhamet Rotkoceri ; Arber Kryeziu ; Petrit Dumnica ; Valdet Dallaku ; Flojera Thaqi ; Blerina Gashi ; Endrit Azizi; Albulena Popaj ; Fitore Murati ; Fatos Rrahmani; Krenar Bajrami; Flamur Kadria ; Irma Konjusha .

Saranda Musliu, ka lindur më 19 qershor 1990 në Ferizaj, shkollën fillore e përfundoi në vendlindje, kurse atë të mesmen në kolegjin Amerikan.

Saranda studion Fakultetin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, në vitin e tretë, dhe është njohëse e mirë e gjuhës angleze.

Është pasionante e shumë aktiviteteve si sportit, biznesit, debateve politike, udhëtimeve, muzikës. Aktivitetet dhe kualifikimet: Menaxhere e shitjes, organizatore çështjeve sociale pjesëmarrëse në konferenca shkencore, përfaqësues e Agjencisë "Iconagency" Part time – Elsam sh.p.k, etj.

STUDENTËT E UBT-së VIZITUAN IPKO TELECOMMUNICATIONS

Prishtinë, 19 janar 2012- Studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), bashkërisht me prof. Besim Limanin, kanë zhvilluar një vizitë studimore në kompaninë “Ipko Telecommunications” në Fushë Kosovë, ku janë njohur me zhvillimin e saj që nga fillimi i punës.

Gjithashtu studentët u njoftuan më për së afërmi me sektorët dhe nënsektorët e sistemeve të kësaj kompanie.

Xhevdet Shala- Inxhinier i planifikimit, u shpjegoi për pjesën e transmetimit të rrjetës, rutimi i një BTS-je deri te BSC-ja, dhe për teknologjinë SDH dhe PDH të cilën IPKO e përdorë në pjesët mobile. Kurse, Fatbardh Dragusha përgjegjës për Planifikim foli rreth teknikat multipleksimit, kanalet fizike dhe logjike dhe stacionin bazë. Po ashtu Arian Halimi, inxhinier i Përkrahjes tha se BSC, MAS, MGW, GGSN, SGSN janë pjesë e procedimit të dhënave të GPRS. Faton Kurteshi u fokusua për ndërlidhjen e pajisjeve të shërbimeve fikse dhe funksionimin e tyre.

Gjatë kësaj vizite menaxhmenti i cekur më lartë ,përveç mikpritjes i ka falënderuar studentët e UBT-së për vizitën e bërë dhe ndër të tjera i ka njoftuar edhe me objektivat zhvillimore dhe aktivitetet vepruese që IPKO do t'i ketë në periudhën vijuese konform planit të tyre.

Ndryshe kompaninë IPKO, sot ka një numër të mirë të punësuar, ku në mesin e tyre ka që kanë përfunduar studimet në UBT si menaxherë të sektorëve të ndryshëm.


Kjo kompani është e njohur edhe në tregun evropian për kualitetin e tyre të lartë.



UBT BASHKËPUNON ME UNIVERSITETIN E UTAH-it NË SHBA

Prishtinë, 8 mars 2012- Fakulteti Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), ka nisë bashkëpunimin me Fakultetin e Shkencave Kompjuterike në Universitetin e UTAH-it në SHBA.

Me konkretisht ky bashkëpunim ndëruniversitar parasheh që studentet e UBT-së e të gjitha niveleve të studimeve si bachelore, master dhe atë të doktoratës dhe stafi i akademik i UBT-së të shfrytëzojnë infrastrukturën e Universitetit të UTAH-it me konkretisht, pajisjet e nevojshme për realizimin e projekteve që bëhet nga Universiteti UBT në lidhje direktet kompjuerike në pajisjet e Universitetit të UTAH-it, dmth si paketat simulative për softëare dhe rrjeta, simulimi dhe analizimi i projekteve të ndryshme si p. sh (rrjete të ndryshme të kompjuete-



rëve duke filluar nga ato bazike deri ne ato me komplekse të niveleve rajonale varësisht nga natyra dhe niveli i projektit). Bashkë-

punimi parasheh edhe krijimin e projekteve të përbashkët nga studentet e të dyja palëve, ku programi i krijuar mund të ketë

qasje nga më tepër se 100 universitete të botës që janë partnere me UTAH-in, edhe analizimin dhe projektimin e sistemeve

të ndryshme të ëireless dhe të telekomunikacionit që janë më të rejtat në tregun mbarëbotërorë.

Këtë bashkëpunim ndëruniversitarë u mundësuan nga palët zyrtare të dyja universiteteve si prodekanin Fakulteti të Shkenca Kompjuterike në UBT, Dr. Petrit Shala dhe palët zyrtare nga Universiteti i UTAH-it, Prof. Dr. Chris Kolar, Manaxher për dokumentacion dhe Prof. Dr. Terri Oda, Manaxher i programit për bashkëpunim në Universitetin i UTAH-it.

“Është një bashkëpunim shumë i mirë, sepse universiteti i UTAH-it vërtetë ka bërë një zhvillim të madh dhe kanë krijuar emër në fushat e kompjuerike dhe inxhinieri. Prandaj, është interes i ynë për një bashkëpunim të tillë”, tha Dr. Petrit Shala, Prodekan në UBT.

UBT NË VAZHDIMËSI BASHKËPUNON ME UNIVERSITETE ANGLEZE

Mars 2012 - Në kuadër të marrëveshjeve të shumta që i ka Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), me universitetet e tjera më prestigjioze në Evropë dhe botë, Presidenti i UBT, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe z. Suresh Konduru, Drejtori i Kolegjit Anglez për IT dhe E-Commerce (CITEC) në Meridian Business School, nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi.

Kjo marrëveshje parasheh bashkëpunim ndëruniversitar, veçanërisht dhënin e diplomave të përbashkët (dyfishta) në arsimin profesional, diploma angleze, në të gjitha nivelet e studimit, me konkretisht studentët e Republikës së Kosovës mund të studiojnë në Angli dhe të pajisen me diploma të dyfishta.



UBT NËN SHKROI MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME IPKO-n

Prishtinë 19 janar 2012- Përveç kombinimit të përvojave më të mira akademike me punën praktike në industrinë e telekomunikacionit, për studentët e UBT, IPKO gjithashtu do të ofrojë tri produkte të veçanta të komunikimit mobil falas brenda rrethit të studentëve dhe stafit të UBT-së, zbritje në telefonat e mençur mobil, me kështë dhe pa kamatë, wireless falas në kampusin e UBT- së, për nevojat e studentëve dhe stafit akademik dhe atij administrativ.

Po ashtu gjatë ditëve në vijim, IPKO do të fillojë promovimin

dhe shpërndarjen e produkteve të veçanta për studentët dhe stafin e UBT-së, ndërsa pas pajisjes me numra mobil nga IPKO, të gjitha njoftimet zyrtare të Universitetit tek studentët do të bëhen në numrat e tyre 049”, u citua gjatë nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit në mes Universiteti për Biznes dhe Teknologji UBT me kompaninë IPKO.

Më tej marrëveshje e bashkëpunimi me IPKO, studentëve të UBT-së do tu ofrohet qasje për punë praktike apo profe-



sionale në kompaninë telekomunikuese, pjesëmarrje në punëtoritë e përbashkëta mes studentëve dhe stafit të kom-

panisë, zbatim i projekteve të përbashkëta mes universitetit dhe IPKO-së, trajnim të stafit të kompanisë, etj.

Më tej citohet se nga kjo marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë IPKO, përfituesit kryesor do të jenë studentët, stafi akademik dhe administrativ i Universitetit UBT.

Bashkëngjitur mund ta gjeni broshurën informative rreth produkteve të ofruara, përmes së cilit ju do të mund të komunikoni dhe bashkëpunoni lirshëm, ndërsa më shumë detaje rreth tyre do të ofrohen nga stafi i kompanisë IPKO, brenda ditëve në vijim.

EKSPERIMENT NË SISTEMIN SMC- PNEUTRAINER- 200

Prishtinë, 6 mars 2012- Studentët e vitit të tretë të Fakultetit Mekatronikë në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT) në bashkëpunim me profesorin e lëndës "Dizajnimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemeve mekatronike", Dr. Sc. Muzafer Shala e duke realizuar eksperimente praktike në Sistemin SMC-PNEUTRAINER- 200, në Laboratorin e Mekatronikës, më konkretisht objektin e UBT-së.

Ky sistem përdoret për inovacione edukative dhe teknologjike në pneumatikë dhe elektropneumatikë.



AMBASADORI GJERMAN NË KOSOVË,
ERNST REICHEL NË DEBAT ME STUDENTËT E UBT-SË

REICHEL: RRUGA E KOSOVËS PËR NË BE VARET NGA PUNA JUAJ

"Deri më tash Kosova është përfaqësuar me UNMIK, emri në tabelën para delegacionit kosovar nëpër takime ka qenë UNMIK. Ose Kosova, sipas Rezolutës 1244. Tash e kemi Kosovë pa UNMIK. Siç e keni kuptuar tashmë edhe fusnota e përmend opinionin e GJND-së dhe Deklaratën e Pavarësisë. A është kjo më mirë apo më keq. Natyrisht që është më e mirë. Ata që nuk e duan këtë nuk po i shërbejnë vendit, për këtë jam i bindur", u shpreh ai



29 shkurt 2012 - Ambasadori gjerman në Kosovë, Ernst Reichel zgjodh një debat me studentët e Universitetit për Biznes dhe Teknologji për të përcjellë te opinionin kosovar qëndrimet e tij dhe të shtetit të tij lidhur me zhvillimet politike në vendin tonë.

"Teoria ime është se ata që nuk duan kompromis nuk e kanë kuptuar Bashkimin Evropian dhe se si shkohet atje. Pa kompromise serioze në politikë multilaterale atëherë nuk do të arrini atje ku doni. Gjithçka tjetër është sikur të jetosh në një botë të fantazisë", tha ambasadori Reichel, gjatë një debati me temë "Sfidat e Bashkimit Evropian", që zhvilloi me studentët e Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT).

"Deri më tash Kosova është përfaqësuar me UNMIK, emri në tabelën para delegacionit kosovar nëpër takime ka qenë

UNMIK. Ose Kosova, sipas Rezolutës 1244. Tash e kemi Kosovë pa UNMIK. Siç e keni kuptuar tashmë edhe fusnota e përmend opinionin e GJND-së dhe Deklaratën e Pavarësisë. A është kjo më mirë apo më keq. Natyrisht që është më e mirë. Ata që nuk e duan këtë nuk po i shërbejnë vendit, për këtë jam i bindur", u shpreh ai.

Duke iu referuar fusnotës, ai tha se "ata të cilët nuk dëshirojnë të bëjnë kompromise shumëpalëshe në çështje, ata ende nuk e kanë kuptuar se për çka është Bashkimi Evropian".

"Ka diçka që nuk pajtohem kur e diskutoj çështjen e fusnotës me njerëzit. Njerëzit mundohen të krahasojnë ku dikush dëshiron të jetë, pra situatë ideale 100%, me situatën e tanishme. Ndërsa unë them se është e tmerrshme, nuk kemi situatë

ideale 100%, por kemi të themi 60%. Dhe ajo që dikush duhet të krahasojë është se ku gjendem tani dhe ku do të gjendem pas kompromisit", theksoi ambasadorin gjerman.

Kur u pyet për heqjen e strukturave paralele serbe nga Kosova, si kusht që kancelarja Merkel i pati dhënë Serbisë për marrjen e statusit të kandidatatit, ambasadori gjerman tha se derisa Këshilli i Evropës do të vendosë për statusin e kandidatatit për Serbinë, çështja e strukturave paralele nuk do të jenë në fokus të debatit, por kjo nuk do të thotë që çështja nuk do të kthehet në diskutimin e radhës mes BE-së dhe Serbisë.

Ndërsa, lidhur me atë se kur Kosova do të hyjë në BE, ai u shpreh: "Kësaj pyetjeje është e pamundur t'i përgjigjesh, sepse ecja për në BE varet nga performanca e vetë shtetit".



PARTY NË IRLANDË PËR FESTËN PAVARËSISË SË KOSOVËS

Irlandë, 17 shkurt 2012 - Studentët e UBT-së të cilët studiojnë në Universitetin e Limerick-ut në Irlandë, përmes projektit "Erasmus Mundus", organizuan party për ditën e Pavarësisë së Kosovës.

Në këtë aheng përveç studentëve të UBT-së si Agron Krasniqi, Anesa Ramaxhiku, Arnisa Kryeziu, Blertë Bytyçi, Burim Ramadani, Egzon Dushku, Njomza Havolli, Rineta Jashari morën pjesë edhe shumë studentë nga America, Australia, Franca, Arabia Saudite, Irlanda, Spanja, Germania, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Italia, Bangladeshi, Rusia, Afrika, India, Kina, Japonia, Tahiti e shumë studentë tjerë nga e mbarë bota.

Party është mbajtur në lokalitë të Universitetit të Limerick-ut (The Stables Club), ku drejtuesit e këtij lokali përveç mikpritjes së madhe të studentëve tanë, kanë lëshuar muzikë në gjuhën shqipe, ku kanë krijuar një atmosferë të mrekullueshme.

Gjithashtu studentët e UBT-së mbajtën një fjalim të shkurtër dhe folën për historinë e shtetit të Kosovës dhe falënderuan shtete mike që ka Kosova.


UBT SPONZORON QËNDRIMIN E PROF. KOTLERIT NË KOSOVË

"Marketingu i bazuar në vlera" është tema e seminarit njëditorë, për të cilën, para shumë të pranishmëve do të ligjërojë Prof. Philip Kotler, profesor dhe njëri prej eksperteve më të njohur në botë në fushën e marketingut.

Seminarin në fjalë është sponsorua, përpos shumë kompanive të mëdha edhe nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji UBT.

Vlen të citohet se profesor Kotleri ka botuar një numër të madhe të tekste shkencore universitare nga fusha e marketingut, dhe shumica nga këto tekste gjenden dhe shfrytëzohen gjatë studimeve në UBT si në nivelin Bachelor dhe atë Master.

Profesorët e njohur nga SHBA, EU por edhe ata vendor të cilët ligjërojnë në UBT në shumicën e rasteve përdorin pandalshëm librat e Kotlerit.



Pasi për studentët e stafin akademik vendorë dhe ndërkom-bëtar të UBT-së, figura dhe krijimtari e prof Kotlerit është i njohur, edhe prania e tyre nuk do të mungojë gjatë zhvillimeve të seminarit me temën "Marketingu i bazuar në vlera", e cila do të mbahet më 29 maj 2012, në Hotel "Emerlad".

ARTA: JAM KTHYER NË KOSOVË T'I KONTRIBUOJ VENDIT TIM



ROLAND LLUKA

Arta Hyseni pas përfundimit të studimeve themelore në Fakultetin Manaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, menjëherë fillon interesimin për studime të mëtejshme dhe për një kohë shumë të shkurtër fiton bursë nga organizata DAAD-OSI scholarship dhe vazhdon për master, program dy vjeçar, në drejtimin International Finance and Economics në Universitetin "Otto von Guericke Magdeburg University" në Gjermani. Pas dy vite pune dhe shumë angazhime, Arta diplomon me temën "Financial markets and coordination games-bank run".

"Kjo temë ka te bëjë më shumë me periudhat e krizës financiare. Psh, një kompani angleze shumë të njohur "Northern Rock", e cila gjatë vitit 2007 ka pësuar bank run që do të thotë se një numër i madh i depozitave kanë krijuar një radhe para bankës për t'i tërhequr depozitat e tyre duke besuar se banka do të bankrotonte. Në fakt "Northern rok" ka qenë në kushte të mira", tha Arta, e cila gjatë këtyre ditëve ka lënë Republikë e Gjermanisë dhe është kthyer në vendlindje ku është punësuar në kompaninë e auditimit "Deloitte", dmth ka rolin e auditorës. Për gazetën "UBT News", thotë se gjatë tërë kohës së studimeve ka menduar të kthehet dhe njohuritë e fituar t'i aplikoj në vendin e vet, dhe menjëherë pas përfundimit të studimeve është kthyer në Republikën e Kosovë.

STUDENTI I UBT -së PUNËSOHET NË ANGLI DHE MENAXHON 76 PUNËTORË

AMIR ASLLANI

Një numër i konsiderueshëm i të diplomuarve në UBT, sot kyqen në pozita të mira udhëheqëse duke përfshirë kompani publike dhe private si në vendin tonë poashtu në rajon dhe në Evropë.

Njëri nga ta është edhe Yll Latifi, i cili për gazetën "UBT News", rrëfen se pas përfundimit të studimeve në Fakultetin e Shkencave Politike dhe Diplomaci në UBT, transferohet në Londër për punësim dhe për studime të mëtejshme.

"Gjate studimeve në UBT mora disa grante që të vazhdoja studimet në disa universitete angleze po ashtu edhe oferta për punësim si në Angli, Gjermani, Austri, Zvicër, Amerike e deri në Kuwait-it, mirëpo duke pas parasysh që një pjesë të jetës e kam kaluar në Londër po ashtu

kisha banesën në këtë qytet, dhe e dija gjuhën angleze vendosa të punësohem dhe të jetoj për momentin këtu".

Ylli tani për momentin është i punësuar në kompaninë më të madhe tregtare në Angli, Marks & Spencer", dhe ka pozitën Head Senior Manager for Costumer Relations dhe menaxhon një numër të konsiderueshëm të punëtorëve.

"Në këtë pozitë kam treguar aftësi shumë të mira me punën për klientë si dhe shumë shpejtë kam mësuar të gjitha politikat e kompanisë në të cilat marrim çdo veprim. Tani udhëheqi një sektor ku kam 76 punëtor që i menaxhoj dhe udhëheqi departamentin më kritik të kompanisë".

Ylli mendon që në një të afërt të vazhdoj edhe studimet postdiplomike dhe oferta të bollshme nuk mungojnë.

"Tani kam një ofertë për bursë të plotë për studime master Greenwich Business School, po ashtu në London City University, por do te pres edhe pak kohë për arsye të punoj dhe të kam financa stabile. Po ashtu planifikoj që të shkoj në London Diplomatic Academy që është pjesë e Ëestminster University dhe aty të përfundoj Master në Diplomaci apo Marrëdhënie Ndërkombëtare, Po ashtu mendoj edhe studimet për doktorate në Diplomaci dhe pastaj të vazhdoj ndoshta punën në kompaninë ku jam".

Ai mendon të kthehet në Kosovë që të ndaj eksperiencat më studentët dhe të ju tregoj atyre se asgjë nuk është e pamundur po të kesh vullnetin, dhe e vetmja gjë që të ndalon nga suksesi është frika e dështimit.

Kompanin" Marks & Spencer", ka 1010 lokacione dhe



zyre të saja në të gjitha anët e botës, ky vetëm në Britani të Madhe ka 700 lokale, kurse në 40

vende tjera të botës ka 310 lokale dhe ka qarkullim vjetor prej 523 milion në vit.

GEORG MITTENECKER NË UBT

Prishtinë, 5 mars 2012- Në UBT vazhdimisht ligjërata zhvillohen edhe nga personalitete dhe profesorë ndërkombëtar të fushave të ndryshme të botës akademike, shkencore etj.

"Advanced IP Multicast and demonstration of the monitoring of the multicast traffic", ishte ligjëratë e radhës në lëndën Multimedia Communicatins, dhe për dy ditë me radhë para studentëve të nivelit Master në Fakultetin Shkencë Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, ka ligjëruar profesori Georg Mittenecker, nga Universiteti Teknik i Vjenës.

Më konkretisht prof. Georg Mittenecker, ka shpjeguar për aplikimet multimediale sikur IPTV, konferencat, mësimi dhe rrugëtimi në

distance, etj. Po ashtu në veçanti ka shtjelluar mënyrat e komunikimit unicast, multicast, broadcast në IPv4 dhe IPv6, arkitektura tipike e komunikimit multicast dhe algoritmet e rrugëtimit, protokollet, etj.

Georg Mittenecker është ligjërues në Universitetin Teknik të Vjenës- Austri. Ka marr pjesë në shumë konferenca shkencore të profesionit që ka dhe ka publikuar një varg punimesh. Është i certifikuar në Cisco Academy, po ashtu është anëtarë i lartë në IPMA. z. Mittenecker në vazhdimësi merret me menaxhim dhe simulime të rrjetave kompjuterike, rrjetave mobile dhe sigurinë e tyre.



NË UBT NISI FUSHATA PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT

Prishtinë, 13 mars 2012. - "Roli dhe rëndësia e mbrojtjes së konsumatorit" ishte tema e radhës, për të cilën, para studentëve dhe stafit akademik vendor dhe ndërkombëtar të Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), ekspertë si dhe përfaqësues të Ministrisë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) së Republikës së Kosovës, organizuan debat dhe në këtë institucion e nisën fushatën "Java e konsumatorit". "Në Kosovë nuk ka informim të mjaftueshëm për mbrojtjen e konsumatorit, por është faza fillestarë dhe shpejti do të kuptohet e drejta personale e konsumatori për në cilindo shërbim", tha Izer Arifi, udhëheqës i Divizionit për Rregullimin e Tregut në MTI. Ai shtoi parimet bazë së mbrojtjes së konsumatorit e disa nga to janë si bashkëpunimi, koordinimi, kontrolli, mbikëqyrja, vetëdijesimi, edukimi etj. Gjithashtu z. Arifi deklaroi se Kosova e ka ligjin për mbrojtjen e konsumatorit, i cili është në funksion dhe i zbatueshëm, po ashtu edhe i krahasueshëm me vendet e rajonit dhe më gjërë.

"Konsumatori ka të drejtë për ti mbrojtur interesat ekonomike, jetën nga rreziku shëndetin dhe pronën; por konsumatori ka të drejtë ankese për t'u mbrojtur në mënyrë nga më të ndryshme

si për kompensime në raste të caktuara edhe për dëmshpërbim. Në Kosovë ekzistojnë mekanizmat institucionale për mbrojtjen e konsumatorit si Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorit në MTI, Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorit, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, Agjencia e Prodhimeve Farmaceutike, Inspektorati Qendrorë i Tregut në MTI, Inspektorati Veterinar dhe Fitosanitar, Inspektorati Sanitar, Inspektorati i për Mbrojtjen e Mjedisit, Inspektorati i Bujqësisë dhe në fund Gjykata", tha ai, duke shtuar se në Kosovë konsumatorin e mbron edhe institucionet më të larta shtetërore si Qeveria e Republikës së Kosovës me ministritë përkatëse si Ministria e Tregtisë dhe Industrisë Ministria e Financave, Ministria e Pylltarisë Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Ministria e Infrastrukturës, Agjencitë tjera qeveritare.

Kurse dekani i Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, prof. dr. Musa Limani tha para studentëve se duhet kontrolluar faturën që del nga arka dhe nëse artikulli nuk ka çmim ose me afat të skaduar, duhet të lajmërohen organet kompetente.

U përmenden edhe aktivitetet shtesë për mbrojtjen e konsumatorit vendor, siç ai për har-



timin e kurrikulave për programin mësimor për mbrojtjen e konsumatorit, në bashkëpunim me Universitetin për Biznes dhe Teknologji dhe MASHT-së.

Në fund të vitit të kaluar UBT-ja pati organizuar konferencë me temën "Mbrojtja e Konsumatorit 2012-2014" dhe gjatë

saj UBT-ja paraqiti hulumtimin sipas të cilit besueshmëria e qytetarëve për produktet kosovare është e ulët. Ishte konstatuar se nuk ka siguri të mjaftueshme, nuk ka kontroll të mjaftueshëm të atyre produkteve dhe nuk ka traditë të gjatë. Për ta ndihmuar shtimin e besueshmërisë, presidenti i UBT-së Hajrizi pati

prezantuar dy iniciativa: Iniciativën për "Quality Kosova" QK, një trup vlerësues për cilësi, si dhe Iniciativën për Zhvillimin e Kurrikulës për Mbrojtjen e Konsumatorit, e cila u patë bërë publike gjatë konferencës në fjalë. Ishte diskutuar mundësia për integrimin e kësaj kurrikule në programet studimore.

EDHE NJË ARTIKULL SHKENCOR NË REVISTËN E NJOHUR NDËRKOMBËTARE "EUROPEAN JOURNAL OF SCIENTIFIC RESEARCH NGA PROFESORËT E UBT-së

NAZMI ZEQRIRI BOTON EDHE NJË ARTIKULL SHKENCOR

Botimi i profesorëve të UBT-së nëpër revista të njohura ndërkombëtare është imperativ i kohës por edhe diçka që po ndodhë. Së fundmi Prof. Nazmi Zeqiri, ligjërues në UBT, ka publikuar një artikull shkencor në revistën ndërkombëtare "EUROPEAN JOURNAL OF SCIENTIFIC RESEARCH (ISSN 1450-216X VOL.69 NO.2 (2012), PP. 234-242), me titull: "Employee Empowerment and Involvement within Post and Telecommunication of Kosova" (shqip: "Fuqizimi dhe Përfshirja e Punonjësve brenda Postë dhe Telekomunikacionit të Kosovës-PTK").

Artikulli në fjalë në fokus të hulumtimit dhe studimit ka angazhimin, fuqizimin dhe përfshirjen e punonjësve në vendimmarrje kurse theksi i veçantë bie në Postën dhe Telekomunikacionin e Kosovës-PTK. Në këtë artikull, sipas Prof. Nazmi Zeqiri, përfshirja e punonjësve në marrjen e vendimeve është një sfidë

për të gjitha kompanitë, sepse kjo shpesh gabimisht kuptohet si humbje e fuqisë dhe e ndikimit të tyre, megjithatë konkludohet se menaxhmenti nuk mund t'i arrijë objektivat e veta zhvillimore pa përfshirjen dhe kontributin e punonjësve.

Për më tepër, kompanitë duhet të hulumtojnë në proceset psikologjike që ndërmjetësojnë në ndikimin e sjelljeve menaxheriale mbështetëse dhe jo mbështetëse në sjelljet e punonjësve lidhur me punën dhe obligimet e tyre.

Gjetjet kuantitative në këtë artikull tregojnë nivel të ulët të fuqizimit dhe përfshirjes së punonjësve nëpër kompani e sidomos tek PTK të arrije fuqizimin e punonjësve dhe përfshirjen e tyre brenda kësaj strukture. Përfshirja dhe fuqizimi i punonjësve do të ndihmojë në menaxhimin e tranzicionit nga kultura monopolistike e organizatës në ekonomi të tregut me

përqendrim të theksuar në fleksibilitet, inovacione, dhe orientim në konsumator, zhvillimin e avantazheve konkurruese dhe kompetencave specifike.

Në këtë drejtim Prof. Nazmi Zeqiri sugjeron hulumtime të tjera në matjen e nivelit të fuqizimit dhe përfshirjes së punonjësve, më theks të veçantë në fokusim të punonjësve të cilët janë në vijë të parë me konsumatorët dhe në mënyrë direkte marrin të dhënat nga ata për ndryshimet eventuale dhe të nevojshme, në mënyrë që të jenë në drejtimin e duhur me nevojat dhe kërkesat e kompanisë.

Ky është publikimi i katërt shkencor nga ana e Prof.Dr.Cand. Nazmi Zeqiri i publikuar nëpër revistat e njohura ndërkombëtare. Gjithashtu ne mësuam se Prof. Nazmi Zeqiri është duke punuar edhe në dy artikuj të tjerë shkencorë dhe publikimi i tyre në revista ndërkombëtare pritet të bëhet në muajt në vijim.

U PUBLIKUA LIBRI SHKENCORË "SISTEMI NDËRKOMBËTAR I NJËSIVE"

Prishtinë 14 maj 2012- Doli nga shtypi libri shkencorë "SISTEMI NDËRKOMBËTAR I NJËSIVE", të autorit Prof. Dr. Sc. Skender Skenderi dhe Prof. Besnik Skenderi, botuar nga Universiteti për Biznes dhe Teknologji, UBT. Recensentët e librit në fjalë janë: Dr. Sc. Rashit Maliqi, prof, ordinar, Dr. Sc. Sylë Tahirsyla, prof, ordinar, si dhe Mr.sc. Qerim Hamiti, prof.

Më konkretisht ky libër i ofron lexuesit informacione burimore dhe të rëndësishme për tërë procesion e zhvillimit të sistemit ndërkombëtar të njësive prej fillimit e deri tek zhvillimet e fundit.

Lidhur me këtë, botuesi i këtij libri më saktësisht Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi tha se duke qenë që nga fillimi i angazhuar për të ndjekur zhvillimet e këtij sektori, shpresojmë që autori edhe në të ardhmen, si edhe deri më tani, do të vazhdojë të japë kontributin e tij duke dokumentuar dhe duke na dhënë edhe botime tjera nga kjo fushë.



Autori, Skender Skenderi, është doktor i shkencave të fizikës, dhe ka një numër të madh të hulumtimeve dhe publikimeve shkencore, deri më sot ka publikuar 6 tekste për shkolla fillore, 28 tekste për shkolla të mesme dhe 27 tekste universitare, 47 nga lamija e informatikës, 4 të ndryshme, gjithsej ka botuar 112 tekste shkencore. Po ashtu që të dy autorët e librit në fjalë janë profesor të rregullt në Universitetin UBT.

Promovimi i librit do të organizohet së shpejt në dhe nga Universiteti UBT, Prishtinë.

KOHLER E MAKOLLI DISKUTUAN ME STUDENTËT E UBT-së

Prishtinë, 31 mars 2012- Kryetari i komunës së Delemontit të kantonit Jura në Zvicër, z. Pierre Kohler, dhe ministri i Diasporës në Qeverinë e Republikës së Kosovës, z. Ibrahim Makolli, kanë marrë pjesë në debatin e organizuar sot në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), në temën "Organizimi i sistemeve të kantoneve në Zvicër".

Të pranishëm në debat ishin profesorë të UBT-së, studentë dhe të interesuar të tjerë, të cilët përcollën me interesim debatin.

Fillimisht, Presidenti i UBT-së, dr. Edmond Hajrizi përshëndeti mysafirët dhe i njoftoi me punën dhe organizimin e UBT-së, si dhe i falënderoi ata për pjesëmarrje në debat në UBT, një universitet që ka traditë të gjatë në organizimin e debateve nga fusha të ndryshme, me interes për studentët dhe për opinionin e gjerë.

Duke folur para pjesëmarrësve në debat, z. Pierre Kohler i ka quajtur të rinjtë e Kosovës dhe studentët e UBT-së të pranishëm në takim, e tashmja dhe e ardhmja e vendit. Ai ka folur me fjalë miradije për shtetin e Kosovës, duke tërhequr vëmendjen se një shtet që ka përjetuar një luftë të tmerrshme, është normale që të ketë probleme në zhvillimin e tij, por me kalimin e kohës vendi do të zhvillohet dhe do të arrijë standardet e larta të zhvillimit dhe të përparimit.

Z. Kohler gjithashtu ka shpjeguar në hollësi organizimin shtetëror të Zvicrës, e cila është e organizuar në 23 kantone, të cilat kanë një autonomi të madhe të organizimit të pushtetit, por gjithnjë në suaza të ligjeve federale, të cilat rregullojnë organizimin në të gjitha segmentet e jetës.

Ai, por organizimit nga niveli federal deri në nivelin e ulët, theksoi se të gjithë udhëheqësit janë të zgjedhur me vota të qytetarëve, të gjitha vendimet në të gjitha nivelet merren me konsensus të plotë, me gjithë diversitetet e shumta që e cilësojnë Zvicrën.

Gjithashtu, ai tha se të gjitha vendimet e rëndësishme për jetën e qytetarëve dhe për çështje me rëndësi merren edhe me referendum popullor, që është forma më e lartë e demokracisë dhe e marrjes së një vendimi që prej drejtpërdrejtë qytetarët.

Z. Kohler, që cilësohet një mik shumë i madh i shqiptarëve, ka folur edhe për organizimin dhe integrimin e shqiptarëve në të gjitha fushat e jetës në Zvicër. Ai foli me fjalë shumë të zgjedhura për punën, organizimin dhe kontributin e shqiptarëve përgjithësisht në kantonin e Juras, si dhe në shtetin e Zvicrës në përgjithësi. Z. Kohler po kështu tha se komuniteti shqiptar që jeton në Zvicër është një urë shumë e mirë lidhëse në miqësinë dhe bashkëpunimin shumë të mirë që ka



shteti i Zvicrës me Republikën e Kosovës, një bashkëpunim ky i dëshmuar dhe që ka dhënë rezultate të dukshme në shumë fusha.

Ministri i Diasporës në Qeverinë e Republikës së Kosovës, z. Ibrahim Makolli, foli në debat për kontributin e madh që ka dhënë dhe po jep në vazhdimësi shteti i Zvicrës për Kosovën, duke qenë një nga shtetet e para që ka dhënë viza në Prishtinë për qytetarët e Kosovës, duke qenë një nga shtetet e para që është deklaruar se Kosova duhet të jetë shtet i pavarur dhe një nga shtetet e para që e ka njohur Republikën e Kosovës.

Z. Makolli po kështu përkujtoi se Zvicra është një nga vendet që ka investuar më së shumti në Kosovë, si dhe ka dhënë kontributin e saj duke qenë pjesë e misioneve ndërkombëtare në Kosovë.

Një theks të veçantë ministri Makolli e vuri te komuniteti kosovar në Zvicër, i cili numëron mbi 230 mijë qytetarë. Ai theksoi se ky komunitet jep një kontribut të madh për Zvicrën, por edhe për vendlindjen, si dhe për lidhjet mes të dy shteteve.

Ministri Makolli theksoi tendencën që gjithnjë e më

shumë të rinj me prejardhje nga Kosova të ndjekin studimet dhe të përgatiten si kuadro akademike, dhe theksoi se ministria që ia drejton do të japë kontributin e saj në këtë drejtim.

Kryetari i komunës së Delemontit të kantonit Jura në Zvicër, z. Pierre Kohler, dhe ministri i Diasporës në Qeverinë e Republikës së Kosovës, z. Ibrahim Makolli, zhvilluan u përgjigjen në vijim të debatit edhe në një varg pyetjesh e çështjesh të shtruara për diskutim nga pjesëmarrësit, profesorët dhe studentët e UBT-së.

ARLINDA, LEANA DHE ARMENDI STAF AKADEMIK NË UBT

VALËZA GELA

Një numër i studentëve të cilët kanë mbaruar studimet me sukses të shkëlqyer në UBT, dhe ma pas kanë vazhduar studime jashtë vendin nëpër Universitete më prestigjioze të Bashkimit Evropian, sot janë kthyer në Kosovë, pikërisht në UBT, për të vazhduar karrierën e tyre në mësimdhënie.

Arlinda për gazetën "UBT News" thotë se njohurit e fituar gjatë studimeve themelore në UBT dhe tana në Universitet Politecnico Di Milano, jenë çelësi i suksesit për të ardhmen e saj, e cila pas diplomimit të studimeve të dyja niveleve kthehet në Kosovë dhe fillon e ligjëron në Fakultetin e Arkitekturës në UBT.

"Jam kthyer në Kosovë ti kontribuoj vendit tim, projektet italiane dhe njohurit e marruar në universitetin Politecnico Di Milano mi transferuar në Kosovë, për dhënie e njohurive dhe për një arsimim më të mirë

gjeneratave që do vijnë, përmes ligjërimit", thotë Arlinda Shaqiri, e cila studimet bachelor i ka përfunduar me suksese në Fakultetin Arkitekturë në UBT, kurse studimet Master po në të njëjtin drejtim, vetëm jashtë vendit më konkretisht në Universitetin Politecnico Di Milano në Republikën e Italisë, dhe diplomon me temën "Exploring hedonism sustainability through social housing, an experimental idea for minimizing of use in big cities."

Ashtu edhe Leana Mahmuti e ndërron mendjen dhe kthehet në Kosovë, ku tash e gjejmë si asistente- ligjëruese e



lëndës Konstrukcione arkitektonike II, në Fakultetin Arkitekturë, ku dhe vet në këtë fakultet i ka përfunduar studimet themelore. Kurse studimet për master jo në UBT por në Universitetin «Politecnico Di Milano» në Republikën e Italisë, drejtimi Arkitekturë, dhe diplomon me temën "Projekti urbanistik dhe arkitektonik në qytetin e Barcelonës". Pas përfundimit të studimeve Leana shkon në Francë dhe menjëherë punësohet në një zyre të arkitekturës në qendër të Parisit, «Park & Associates», dhe paralelisht punës e përvetëson gjuhën frënge në një shkollë të gjuhëve në Paris.

Edhe Arment Merovcin e gjejmë si asistent-ligjërues


në Fakultetin Ekonomi në UBT, po ashtu edhe Armendi studimet themelore i ka përfunduar në këtë fakultet, e studimet Master i ka mbaruar në Finance and Investments në "Queen Mary University of London" në Londër, në Angli. Pas përfundimit të studimeve punësohet në kompaninë për shërbime financiare "Thomas Murray", në Angli. Nga 2010 e vazhdon karrierën në Kosovë në këto në pozita të ndryshme, në Ministrinë e Financave në Qeverinë e Republikës së Kosovës, ku ende është aktual. "Arsyeja kryesore që më ka shtyrë të studioj në UBT ka qenë kurrikula e universitetit. Po ashtu, edhe profesorët kanë qenë shumë të mirë dhe me përgatitje të lartë profesionale dhe shkencore".

Përveç këtyre treve, UBT ka edhe një numër të madh të studentëve të cilët janë duke mbaruar studimet jashtë vendit, jo vetëm Mastër por edhe studime të doktoratës, të cilët do paraqesim në numrin e gazetës në vijim.

FLASIN LEXUESIT E GAZETËS SË STUDENTËVE TË UBT-SË

"UBT NEWS", PJESË E PANI

"Trajtimi i sferave Politikë, Ekonomi, Biznes, Teknologji, Edukim, Shkencë dhe Kulturë e bënë këtë gazetë të një dimensionit dhe niveli shumë të lartë profesionalizmi dhe kredibiliteti. Rubrikat më të pëlqyera dhe nga të cilat opinioni publik në Kosovë, rajon e më gjerë do të përfitonte shumë janë si intervista me profesor e personalitete të ndryshëm, prezantimi i inovacioneve apo hulumtimeve të ndryshme në shkencë dhe sporti vendor"



Valëza Gela

"UBT News" e këndshme, e paruarur, e sinqertë. Fjalët kyçe për një gazetë të tillë që ngërthen në vete tema nga më të ndryshmet punuar nga studentët dhe profesorët e UBT-së. Tema nga jeta shoqërore, kulturore dhe artistike, intervista, punime shkencore etj. Këto pika kyçe e bëjnë të këndshme dhe tërheqëse për lexim këtë gazetë, ngase mund të gesh materiale të llojllojshme që janë në interesin tonë. Mendoj se kjo gazetë ka numër të madh të lexuesve dhe me të vërtetë ia vlen të shndërrohet në një gazetë ditore, të shtrijë lexueshmërinë e saj edhe në rajon e më gjerë, pasi që përmban tema mjaft interesante të punuara me mjeshtëri të lartë. Prandaj uroj që ky qëllim të realizohet sa më parë, dhe "UBT News" të bëhet me lexueshmërinë më të lartë në vend dhe jashtë tij.



Kaltrina Bunjaku

Këtë gazete e lexoj më së shumti sepse në brendinë e saj ka tekste akademike të cilat janë dedikuar studentëve të universitetit, zhvillimit të shkencës bashkëkohore të lëmenjve të ndryshme, për ngritjen e cilësisë së studimeve etj. Në të gjejmë edhe opinione të studenteve të cilët flasin për rrjedhën e studimeve dhe për problemet studentore. Prej rubrikave më së shumti më pëlqejnë intervistat me studentët dhe profesorët.

Gazeta e UBT-së dallohet nga gazetat e përditshme sepse në të nuk ka politikë, nuk ka shkrime nga ndodhitë e përditshme në

rajon dhe në botë. Mendimi im është që UBT-ja të ketë një gazetë e cila dallohet nga gazetat e tjera të përditshme, gazetë e cila do të ishte e përvajshme, por me theks të veçantë për jetën studentore, procesin mësimor, të arriturat shkencore dhe me tekste të shkruara nga profesorë eminentë të lëmenjve të ndryshme për punën e tyre shkencore. Me këto përmbajtje gazeta do të lexohej si në Kosovë dhe në rajon.



Kushtim Qerkini

Gazetën "UBT News" e lexoj më së shumti sepse është gazetë korrekte, ku çdo artikull ka përmbajtje, domethënie dhe informacion të duhur. Mendoj se puna që bëhet në këtë gazetë bëhet më një përkushtim të madh, dhe ky përkushtim do ta çojë gazetën drejt një piedestali të lakmueshëm jo vetëm nivel vendi por edhe ndërkombëtar.



Agron Sverkaj

"UBT News" është gazeta që unë e lexoj dhe pres me padurim numrin e ri. Arsyeja pse unë e lexoj këtë gazetë qëndron në atë se çdo gjë që shkruhet në këtë gazetë ka të bëjë me realitetin dhe me ngjarjet e së afërmes. Më të vërtetë jemi lodhur nga gazetat ditore ku secila prej tyre ka tematikë politike, kurse "UBT News", ka informacione frytdhënëse informacione reale dhe të dobishme për student. Kisha kërkuar më shumë që kjo revistë që të lansoj ekzemplar të rinj sa më shpesh bile mundeshit të

bëhet revista javore si dhe të ketë edhe ma shumë tema shkencore.



Atthe Buja

Faleminderit për përzgjedhje që më keni bërë dhe më jepni këtë nder për të shkruar për gazetën e Universitetit tonë - UBT. Trajtimi i sferave Politikë, Ekonomi, Biznes, Teknologji, Edukim, Shkencë dhe Kulturë e bënë këtë gazetë të një dimensionit dhe niveli shumë të lartë profesionalizmi dhe kredibiliteti. Rubrikat më të pëlqyera dhe nga të cilat opinioni publik në Kosovë, rajon e më gjerë do të përfitonte shumë janë si intervista me profesor e personalitete të ndryshëm, prezantimi i inovacioneve apo hulumtimeve të ndryshme në shkencë dhe sporti vendor.

Mendimi im është që në të ardhmen të shihen mundësitë nga UBT që kjo gazetë me këtë nivel të informacionit të ketë shtrirje në gjithë vendin, si në shtyp por edhe në botën elektronike. Pritjet në lexueshmërinë e kësaj gazete janë në zgjerim të maksimumit deri tanishëm.



Betim Gashi

Gazeta e UBT-së na shërben si një mjet shumë i mirë informimi, prandaj edhe e lexojmë çdo numër të saj, sepse ajo çfarë na tërheq është shkrimet dhe mënyra e të organizuarit e gazetës ku tek ne lexuesit zgjon një interesim të madh po përmendim si p.sh bashkëpunimet me Universitetet tjera, ngjarjet të cilat organizohen brenda UBT-

së ose edhe jashtë, por që në një mënyrë apo tjetër ndërliidhen më drejtimit tona që ne studiojmë.

Në të ardhmen mendoj se gazeta duhet të kalojë nga mujore pse jo në javore pasi që tani është një jetë dinamike, dhe botimi javor do të ishte shumë i mirëseardhur tek ne si student. Rubrikat që parapëlqejmë më së shumti janë ato që lidhen me Teknologjinë pasi që edhe studioj për Shkenca Kompjuterike.



Durim Dabiqaj

Është një ndër gazetat që ja vlen të lexohet me kujdes sidomos këtë e apeloj tek gjeneratat e reje. Në qoftë se e lexon këtë gazetë lirisht mund ta ndiesh veten të privilegjuar sepse me këtë je me afër çdo informacioni lidhje me jetën studentore, me zhvillimin e teknologjisë vendore dhe asaj ndërkombëtare. Unë kisha propozuar që kjo gazetë me kalimin e kohës të bëhet e përditshme dhe ta krijoj lexueshmërinë edhe në trojet shqiptare.



Fitim Tasholli

Unë si lexues i rregullt i gazetës "UBT News" jam shumë i kënaqur me punën që e bën redaksia, arsyeja pse unë e lexoj gazetën "UBT News" është se dua të jem sa më i informuar me aktualitetin e ngjarjeve që ndodhin në UBT.

Sipas mendimit tim dallimi në mes gazetave ditore dhe "UBT News" është shumë i madh, sepse gazetat ditore kryetitujt flasin rreth lajmeve më shokuese dhe brengosëse të jetës aktuale

në Republikën e Kosovës dhe më gjerë, në "UBT News" argëtohem duke i lexuar kuriozitetet, për suksesin e kolegëve në Universitete jashtë shtetit, për marrëveshjet ndëruniversitare të arritura ndërmjet Presidentit të UBT-së Edmond Hajrizi dhe homologëve të tij, pa dyshim që bindem se UBT është mundësia e artë për sukses në karrierë dhe në jetë. Normale është që aktivitetet që ndërmerr UBT-ja në Departamentin e robotikës jep një imazh tjetër shtetit tonë, pse mos të dalë kjo gazetë edhe jashtë shtetit tonë të informohen më shumë për UBT.



Flamur Sadriu

Është gazetë e kapacitetit të lartë e cila në çdo faqe ka informacione të bollshme, nuk mundem me thënë që është gazeta më e mira në Kosovë por renditet në mesin e tyre. I uroj që në një të ardhme të afërt të publikohet si gazetë ditore.



Hekuran Sahiti

Unë mendoj se në gazetën "UBT News", ceken shumë tema të ndryshme që prekin shumë sfera të cilat mund ta na ndihmojnë neve si studentë të UBT-së, por edhe student tjerë të cilët kanë rast me lexuar këtë gazetë. Gazeta në fjalë është e nivelit të lartë dhe ka përmbajtje serioz në të gjitha rubrikat.

DASHME E ÇDO STUDENTI



Liridon Ajeti

Si student i UBT-së jam shumë i kënaqur me gazetën e universitetit ton. Kjo gazetë përmban informacione të ndryshme për universitetin po ashtu edhe informacione të përgjithshme që kanë rëndësi për ne, dhe mendoj se është mjaftë edukative. Shpresoj se në një të ardhme të afërt edhe gazeta "UBT News" të filloj të jetë gazetë ditore, sepse nuk kemi asgjë me pak se ato ditore që i kemi, pa problem mund të hasmi në lexueshmëri jo vetëm në Kosovë por edhe me gjerë.



Liridon Çerkini

Gazeta "UBT News" më pëlqen për ta lexuar sepse jep informata interesante lidhur me jetën dhe punën studentore të studentëve të të gjitha drejtimeve që i disponon Universiteti i UBT-ës. Propozoj që kjo gazetë artikujt që i ka me interes shkencor mundësisht ti përkthehen edhe në gjuhën angleze në mënyrë që të mësojmë gjuhën dhe termat teknike angleze.



Liridon Zeqiri

Unë gazetën e UBT-së e lexoj sepse mund të gjej shumë informacione rreth fakultetit dhe zhvillimeve me të reja të UBT-së. Më së shumti më pëlqejnë rubrikat të cilat japin informacione më shumë rreth Universiteteve tjera të cilat lidhin marrëveshje me UBT-në dhe informacione të reja të cilat i zhvillon presidenti i UBT-së prof. Dr. Edmond Hajrizi. Mendoj se gazeta e UBT-së duhet të shtrihet në tërë territorin e Kosovës, sepse në Kosovë mungon një gazetë e cila duhet të ketë më shumë informacione për studentët p.sh rreth studimeve jashtë vendit, rreth zbulimeve të reja shkencore që ndodhin dhe shumë e shumë tjera.



Muharrem Muzaqi

Një ndër arsyet e leximit të "UBT News" është informimi mbi rrjedhat e brendshme në Universitetin ton. Për ne si studentë gazeta në fjalë është një informator bazë mbi zhvillimet dhe të reja në Fakultetin tonë.

Unë mendoj se "UBT News" dallon nga gazetat e tjera në bazë profesionalizmit, korrektësisë dhe paanshmëri politike. Mendoj që në të ardhmen gazeta në fjalë të bëhet gazetë ditore dhe ku një ditë korriku duke pshuar në plazhin e Sarandës apo të Durrësit të gjithë turistëve në dore "UBT News" dhe me plot dëshirë e nostalgji ta lexoi jo veç unë por të lexohet në të gjitha trevat shqiptare.\



Qendrim Hetemi

Pasi jam pjesë e këtij Universiteti më pëlqen të lexoj këtë

gazetë që të jem i kyçur për më të reja në fakultet, lidhjet që bën fakulteti ynë me universitetet tjera në Evropë e më gjerë. Nuk do veçoja ndonjë rubrikë pasi gjithmonë mendohem ta lexoj të gjitha dhe të njoftohem për më të reja. Ia vlen që në të ardhmen stafi i gazetës së UBT-së të mendoj për shtrirje e saj më gjerë, duke punuar më shumë dhe të na informoj për lajmet ditore e jo vetëm rreth fakultetit tonë, edhe pse kjo e fundit është tepër e nevojshme për neve. Shpresoj që në të ardhmen e afërt gazeta e UBT-së të bëhet pjesë e pashmë e jona.



Selami Klaiqi

Jam lexues i rregullt i gazetës "UBT News" dhe mendoj që është një gazetë e qëlluar. Një prej arsyeve që e lexoj është sepse dua të di më shumë për ngjarjet që ndodhin në fakultet, por edhe për më të reja në të gjitha fushat. Rubrika e cila më pëlqen është rubrika e cila trajton të arriturat e studentëve të UBT-së në vend dhe në arenat ndërkombëtare. Mendoj që në të ardhmen së paku të jetë kjo gazetë javore dhe të shpërndahet edhe jashtë Kosovës duke pasqyruar të arriturat që bëhen në UBT dhe lidhur me kushtet e studentëve.



Rilind Duriqi

Gazetën "UBT News" e lexoj rregullisht për faktin se aty gjej informacione për Universitetin në të cilin studioj dhe lajme të tjera që i përkasin nivelit shtetëror. Nuk kam ndonjë preferencë të veçantë për ndonjë rubrikë,

thjesht më pëlqen e gjithë gazeta. Shpresoj që në të ardhmen kjo gazetë të gjeje shtrirje në gjithë Kosovën, pse jo dhe më larg. Do preferoja që në kuadër të gazetës të punonin edhe studentët pasi do të ishte një eksperience e mirë për të gjithë, për të parë më afër punon e lodhshme që kanë gazetarët njëherit edhe atraktiv.



Arianit Elshani

Gazetën e "UBT News", e lexoj rregullisht sepse aty gjej informacione nga më të llojllojshme, nganjëherë janë edhe inspiruese për faktin se gjene rubrika ku studentët të cilët kane studiuar në UBT tani magjistrojnë jashtë vendit dhe kane sukses të madh. Me një angazhim më të madh dhe me kreativ besoj se gazeta do të jetë një qendër e informacionit për studentet dhe menaxhmentin e UBT-së. Po ashtu mendoj se kjo gazetë mund të ketë shtrirje edhe në gjithë Kosovën për faktin se ka një mori informacionesh.



Amir Asllani

Gazeta studentore e UBT-së "UBT NEWS", e cila botohet në kuadër të këtij Universiteti, është gazetë e studentëve dhe e mësimdhënësve të këtij institucioni edukativo-arsimor privat në Republikën e Kosovës. Si një tribinë informative e këtyre fushave, ajo ka dhënë informacione të ndryshme me shkrime të studentëve dhe të personelit mësimor, duke filluar nga punimet e studentëve, të mësimdhënësve, si dhe të punës së personelit ud-

hëheqës për arritjet e mëtejshme akademike për studime cilësore e kreative të studentëve.

Ky botim gazetaresk, edhe pse muhor, lirisht mund të themi se radhitet në mesin e gazetave të përditshme shqipe që botohen në Kosovë, por edhe më gjerë. Ka thyerje të një gazete ditore, që nuk e dallon shumë nga ato, me përjashtim të informacioneve ditore dhe aktiviteteve të tjera që ndodhin në Kosovë, rajon dhe botë, sepse nuk është ditore. Ndërkaq, sa u përket ngjarjeve mujore, ato janë të pranishme me korrektësi dhe me pasqyrim real. Edhe burimet publicistike të shkrimeve janë të kodit gazetaresk, në përputhje me normat dhe rregullat e ligjesisë gazetareske.

Nga shikimi im, mendoj, se kjo gazetë me kompletimin e një ekipi më të gjerë redaktorial e gazetaresk, mund të avancohet në një të përditshme shqipe të Kosovës, si një dritare e re, ku mund të plasohen shkrimet tekniko-teknologjike, të biznesit dhe të zhvillimeve të tjera në vend, rajon e më gjerë.

Shpreh kënaqësinë si pjesë e kësaj tribuneje informative, që gazeta të bëhet e përditshme.

Urime e suksese iniciatorëve dhe përkrahësve për ngritjen e saj në ditore.

Anketoi: Filloreta Hasani dhe Halil Nallbani



**TOP EDUCATION
FOR
TOP STUDENTS**

TOP STUDENTS FOR

BISEDË ME PROF. DR. MUSA LIMANIN, DEKAN I FAKULTETIT MENAXHMENT, BIZNES DHE EKONOMI NË UNIVERSITETIN PËR BIZNES DHE TEKNOLOGJI

LIMANI: UBT UNIVERSITETI MË PRESTIGJIOZ NË VEND

"UBT-ja dhe njësitë e saja pedagogjike (fakultetet), ofrojnë profesionalizëm, shkencë dhe dituri, e jo diploma fiktive. Këtë konstatim, më së miri e vërteton praktika, sepse studentët që i kanë kryer fakultetet përkatëse në kuadër të UBT-së nuk kanë problem të punësohen, pikërisht pse disponojnë nivel të lartë të profesionalizmit", tha Prof. Dr. Musa Limani

"UBT News"- I nderuar profesor, përveç që jeni profesor jeni edhe dekan i fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në Universitetin për Biznes dhe Teknologji UBT. Si e vlerësoni e këtë departament në përgjithësi nga dita e parë e deri më sot?

Limani: Në UBT që nga viti 2010 jam në marrëdhënie të rregullt pune dhe njëherit e kryej detyrën e Dekanit të Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi. Edhe para se të vijë në këtë Universitet kam pasur informate se është ndër universitetet më prestigjioze private në Kosovë, gjë që tani jam bindur edhe praktikisht. Fakulteti Ekonomik në kuadër të UBT hyn në radhën e njësisve akademike me numër të madh të studentëve. Që nga dita e parë fitova përshtypjes se këtu ka rregull, disiplinë dhe sukses. Nga menaxhmenti i UBT-së ofrohen kushte të volitshme për procesin mësimor, si për student ashtu dhe për stafin akademik. Marrë parimisht, stafi akademik është në nivel të detyrës pedagogjike, kurse studentët janë të disiplinuar (heq distancë përjashtime që janë shumë të vogla), të rregullt në ligjërata e ushtrime. Falë angazhimit të pedagogëve dhe interesimit dhe punës të studentëve, suksesi në provime dhe në hallkat e tjera të procesit mësimor është i mirë. Unë si dekan dhe si pedagog i këtij fakulteti jam i kënaqur, si me vijimin e ligjëratave, ushtrimeve dhe suksesin në provim nga ana e studentëve, po ashtu dhe me punën e pedagogëve në të gjitha hallkat e procesit mësimor, por kjo në asnjë moment nuk do të thotë se nuk mund të jetë edhe më mirë. Pa hezituat mund të them se për ka suksesi dhe cilësia, studentët e fakultetit tonë janë superior, jo vetëm në kuadër të Kolegjeve universitare private, por edhe të Universitetit publik të Kosovës e më gjerë. Besoj se në të ardhmen do të korrim suksese edhe më të mëdha.

UBT News: Cilat janë përparësitë dhe vështirësitë ta menaxhoni një departament të tillë?

Limani: Të jesh udhëheqës i një fakulteti nuk është lehtë, sepse pos punëve personale dhe pedagogjike në procesin mësimor, ngarkohesh edhe me punë plotësuese si dekan që rrjedhin nga kompetencat statusore. Përparësitë e mia në postin e deka-



nit, qëndrojnë në faktin se kam përvojë menaxhuese, pasi që në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, në dy mandate kam qenë prodekan për çështje mësimore. Kjo përvojë më ka ndihmuar që mos të përballem me ndonjë problem, përkundrazi atë e kam bart në Fakultetin Ekonomik të UBT-së, normalisht duke ia përshtat kushteve dhe rrethanave të reja. Sa i përket vështirësive, mund të them se nuk kam dhe nuk përballem me ndonjë problem që duhet veçuar. Ndonëse, vështirësitë ekzistojnë, por ato janë të natyrës që paraqiten në procesin mësimor, qoftë kur bëhet fjalë për vijimin e ligjëratave, të ushtrimeve, apo keqsjelljen e disa studentëve në provime, apo mungesën ndonjëherë të pedagogëve në ligjërata apo në provime. Mirëpo, të gjitha këto probleme i zgjidhim në bazë të Statutit. Andaj, mund të them se nuk kam pasur e as nuk kam kurrfarë problem.

Kriter kryesor që tërheq studentët të studiojnë në Universitetin tonë, dhe konkretisht në Departamentin: Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, është pikërisht cilësia!

UBT News: Çfarë është interesi krahasuar me vitet e kaluar që të studiohet në këtë departament dhe sa jeni të kënaqur...?

Limani: Është për të konstatuar se, interesimi i studentëve është i madh, jo vetëm në Fakultetin Ekonomik, por në nivel të

UBT-së. Kriter kryesor që tërheq studentët të studiojnë në Universitetin tonë, dhe konkretisht në Departamentin: Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, është pikërisht cilësia. Këtë e vërtetoj edhe numri i studentëve të regjistruar në këtë vit akademik, i cili kaloi numrin mbi 800 veta. Unë si dekan kam pasur rast të bisedojmë me disa student që janë transferuar nga publiku në fakultetin tonë. Përgjigja e tyre ishte, se ata janë të interesuar të bëhen ekonomist, e jo të marrin vetëm një diplomë në letër. Në kontekst të kësaj, mund të them se UBT-ja dhe njësitë e saja pedagogjike (fakultetet), ofrojnë profesionalizëm, shkencë dhe dituri, e jo diploma fiktive. Këtë konstatim, më së miri e vërteton praktika, sepse studentët që i kanë kryer fakultetet përkatëse në kuadër të UBT-së nuk kanë problem të punësohen, pikërisht pse disponojnë nivel të lartë të profesionalizmit.

UBT News: Me kërkesat e tregut, sa iu përgjigjeni ju atyre si institucion akademik?

Limani: Departamenti: Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, përparësitë e nevojta të ekonomisë së tregut. Andaj, të gjitha planet dhe programet në kuadër të fakultetit tonë i përgjigjen kërkesave të ekonomisë së tregut. Pra, në përgatitje student me aftësi dhe me njohuri të veprimit të ligjeve ekonomike, përkatësisht të veprimit të ekonomisë së tregut. Andaj, në bazë të këtyre përgatitjeve, mund të themi se studentët

tanë, janë konkurrent në tregun e punë, jo vetëm në Kosovë, por edhe në Evropë e më gjerë.

UBT News: A do të mundnit ju dhe studentët tuaj të UBT-së të kontribuonit në përmirësimin e kësaj gjendjeje kaosi që po mbretëron në sektorin e ekonomisë në Kosovës?

Limani: Siç është e njohur, UBT-ja, pos procesit mësimor në kudër të vet ka dhe veprimtarinë hulumtuese-shkencore. Andaj, nga aspekti profesional-shkencor, UBT-ja dhe konkretisht fakulteti jonë, ka potencial akademi, duke i përfshirë edhe studentët të përgatisë strategji dhe koncepte zhvillimore për sektor të caktuar të ekonomisë, apo edhe për ekonominë në tërësi. Mirëpo, kjo nuk varet vetëm prej nesh, por nga institucionet vendimmarrëse, për të nga angazhuar të bëjmë studime të tilla.

Konference ndërkombëtare me temën "Politikat e zhvillimit ekonomik"

UBT News: UBT në vazhdimësi organizon konferenca të karakterit shkencorë, po departamentin që menaxhoni ju keni plan për këtë vit kalendarik ne këtë vij?

Limani: Po, atë që thash se UBT-ja organizon konferenca shkencore vendore dhe me karakter ndërkombëtar. Ne si Departament kemi paraparë që në qershor të këtij viti të organizojmë një Konferencë ndërkombëtare me temë: Politikat e zhvillimit ekonomik.

UBT News: Po për shoqërinë tonë këtu në Kosovë studentet e diplomuar sa kane hapësirë?

Limani: Në periudhën e pas luftës, trendët ekonomike në Kosovë nuk ishin të volitshme. Për kah nivelin e zhvillimit të forcave prodhuese, Kosova hynë në radhën e vendeve më të pazhvilluara të rajonit dhe bënë pjesë në kuadër të vendeve jo mjaft të zhvilluara të botës. Andaj, niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, nuk mundëson edhe punësim të duhur të gjeneratave të reja që paraqet sfidën kryesore të rinisë sonë, prandaj edhe të studentëve të UBT-së. Siç dihet, norma e papunësisë në Kosovë është shumë e lartë, sipas Entit të Statistikës së Kosovës kjo normë më 2010 ishte 45,6%, që tregon se mundësia për punësim në vendin tonë është e vogël.

UBT News: Dhe së fundi, çfarë do t'i porositni ju studentët tuaj, por edhe institucionet përgjegjëse lidhur me sektorin e ekonomisë që sot po zhvillohet në Kosovë, është e qëlluar apo duhet ndryshuar?

Limani: Mesazhi im si pedagog për studentët tanë është që të mësojnë dhe të dalin ekonomistë të aftë, sepse vetëm kjo u mundëson perspektivë dhe punësim, që është në rend të parë në interesin e tyre personal, si dhe në interesin e Kosovës, për arsye se udhëheqja e politikave ekonomike në të ardhmen të vendit tonë do të jenë në duar të tyre. Ndërkaq, sa i përket institucioneve tonë, përkatësisht atyre që hartojnë dhe zbatojnë politikën ekonomike, mund t'u themi se duhet të merren më shumë me politikën zhvillimore makroekonomike se sa që kanë bërë deri më tani. Me qëllim që të ndryshohen trendët negative zhvillimore, Qeveria e Republikës së Kosovës me të gjithë dikasteret e veta duhet të hartojë strategji zhvillimore dhe të zbatojë politikë konsekuente ekonomike. Efektet e zhvillimit ekonomik të ekonomisë së Kosovës në periudhën e pas luftës, më së miri tregojnë se politika ekonomike e zbatuar deri më tani nuk ishte efikase. Andaj, për të siguruar një zhvillim më intensiv ekonomik, nevojiten reforma rrënjësore ekonomike, duke përfshirë këtu edhe reformat në instrumentet e politikës fiskale, të politikës së tregtisë së jashtme dhe politikës monetare-kreditore, në kuptimin që ato të futen në funksion të zhvillimit ekonomik.

Intervistoi: Yllka Abdullahu dhe N. Demiri

NGA UBT NË UNIVERSITETE TË VENDEVE TË BASHKIMIT EVROPIAN

STUDENTËT E UBT-SË, AMBASADORË TË DIJES KOSOVARE NË BOTË

Studentë të UBT-së, të cilët janë përfitues të bursës nga projekti i "Erasmus Mundus", projekt i Bashkimit Evropian, flasin për "UBT News"

N. DEMIRI

Këtë vit dhe për katër vitet e ardhshme dhe i vetmi në vend dhe rajon prej universiteteve private, Universiteti për Biznes dhe Teknologji UBT është përfitues i projektit "Erasmus Mundus", projekt i Bashkimit Evropian. Nga ky projekt, po në këtë vit, 22 studentë të këtij universiteti kanë fituar bursa të plota studimi për vitin akademik 2011-2012, në të gjitha nivelet e studimit si bachelor, master dhe të doktoratës. Ata kanë filluar mobilitetin e tyre në universitetet më prestigjioze të vendeve të Bashkimit Evropian.

Studentet të cilët janë përcaktuar për studime themelore janë: Në Universitetin Limerik në Irlandën janë pranuar këta studentë: Njomza Havolli, Bler-të Bytyçi, Egzon Dushku, Anesa Ramaxhiu, Burim Ramadani, Rineta Jashari, Arnisa Kryeziu, Agron Krasniqi, kurse në Universitetin City në Londër në Britani të Madhe janë pranuar: Drilon Zenuni, Rina Sadriu, Ndrizim Idrizi, Diana Llugaxhiu, Fatlum Gërguri, Haris Haxhimehmeti, Shkurta Berisha dhe Arian Again. Në Universitetin Freie të Berlinit është pranuar Qëndresa Sopjani, Erodita Llugaxhiu, Mirsad Kosumi në Universitetin e Bukureshtit në Rumani dhe Lirigzona Morina në Universitetin Lapenarta në Finlandë. Po ashtu përmes këtij projekti ka kandidatë që janë pranuar për studime të pos-doktoratës në "City" në Londër etj.

UBT mban kontakte të vazhdueshme me këta studentë, të cilët e kanë për obligim të paraqesin raport në çdo kohë për procesin e studimeve në vendet ku janë. Semestrin që e lamë pas, shumica nga ta kanë qenë në pushime në Kosovë dhe vizituan edhe UBT-në dhe shprehën pikëpamjet e tyre rreth vendit se ku po studiojnë dhe jetojnë dhe aktivitete e tyre jashtë studimeve. Ata me një fjalë janë shumë të lumtur dhe që janë pjesë e UBT-së, dhe për mundësinë që u është dhënë për të depërtuar jashtë vendit për studime të mëtutjeshme. Po ashtu, shumica nga ta mezi presin të kthehen dhe të kontribuojnë në Kosovë.

Anesa: "Sa shumë më kish munguar vendi im"

Universiteti Limerik është një ndër universitetet më të njohura të Irlandës. Ky Universitet ka kampusin që ka objektet e



Anesa Ramaxhiu



Rineta Jashari



Lirigzona Morina



Burim Ramadani



Erodita Llugaxhiu



Shkurta Berisha



Agron Krasniqi

veta të veçanta për secili drejtim të studimeve që ofron. Anesa Ramaxhiu, e cila dy vitet e para të studimeve themelore i ka përfunduar në UBT në drejtimin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, kurse vitin e tretë, sikurse 22 kolegët e vet të UBT-së fitoi bursë nga projekti "Erasmus Mundus", dhe vazhdon në Universitetin e Limerikut në Irlandë po në drejtimin e njëjtë, thotë: "Nuk ka qenë aspak e vështirë që të kapi ritmin e njëjtë me studentët e këtij universiteti. Falë UBT-së dhe sistemit të mirë për mësim, unë kam qenë shumë e informuar për të gjitha ato sfera të ekonomisë që i kam mësuar".

"Semestri i parë ka qenë një sfidë e madhe. Nuk ishte edhe aq e lehtë të adaptohesh në një ambient i cili është tërësisht i ndryshëm me atë në të cilin je mësuar të jetosh. Por, vlen të përmendet që Irlanda ka një shoqëri shumë të ngrohtë dhe shumë të afërt, fakt që na ka ndihmuar që ne të adaptohemi sa më shpejt", shton ajo.

Anesa thotë se universiteti ku po studion është një mrekulli e vërtetë, duke nisur nga sistemi

i mësim, mënyra e ligjërimit, kreativiteti dhe shoqërimi me studentë të nacionaliteteve të llojllojshme të vendeve të ndryshme të botës. "Këtu vetëm se bëhet shkëmbimi i kulturave, mësojmë gjëra të reja, fjalë në gjuhë të ndryshme, ushqime dhe specialitete, mënyra të mësim, thotë ajo dhe shton se Irlanda është vendi më i bukur që ka parë ndonjëherë, me një natyrë të veçantë si askund tjetër.

"Çdo cep i këtij vendi është thjesht i mbushur me bukuri natyrore të paimagjinuara. Po ashtu në Irlandë mundësitë janë më të mëdha se në Kosovë, si mundësia të merrem me sporte të ndryshme, me aktivitete të cilat në vendin tonë nuk ka mundësi që të bëhen etj. Mund të shkosh në aktivitete si p.sh: të ngasësh biçikletën në male të ndryshme, të bësh ngjitje në shkëmbinj të mëdhenj, të kërcesh nga aeroplani me parashutë, të kalërosh etj. Jam shumë e lumtur që jam pjesë e këtij universitet për një vit të tërë".

Po ashtu pas përfundimit të semestrit të parë shumica nga ta, të cilët kanë vazhduar e studimeve jashtë vendit përmes projektit "Erasmus mundus" kanë qenë për pushime semestrale në Kosovë, dhe një pjesë të kohës e kanë kaluar edhe në UBT, ndër ta edhe Anesa e cila thotë: "Nuk mund të besoj sa shumë më kishte munguar vendi im. Jam takuar me më të dashurit e mi dhe kam kaluar momente të mrekullueshme. Kam qenë në UBT dhe jam magjepsur me ndryshime e qëlluara që ishin bërë".

Rineta: Nga Irlanda do kthehem në vendimi tim

"UBT është një universitet me një background të pasur. Mua studimet në UBT më dhanë mundësinë t'i vazhdoj dhe studimet jashtë Kosovës dhe vet bashkëpunimi i UBT-së me universitetet ndërkombëtare e bën atë të jetë shumë i afërt me universitetet e tjera në rajon dhe botë. Për mua ishte një privilegj dhe fat që kam studiuar në UBT", thotë Rineta Jashari, e cila studimet themelore i ka përfunduar në Fakultetin e Arkitekturës në UBT, kurse për vazhdimin e studimet master fitoi bursë nga projekti "Erasmus Mundus" dhe ato po i vazhdon në Universitetin e Limerikut në Irlandë.

"Irlanda e ka traditë mikpritjen dhe respektin për njëri tjetrin. Kjo për një të huaj në këtë vend ka një rëndësi shumë të veçantë. Mikpritje kam hasur edhe prej studentëve të UBT-së, të cilët kishin shkuar disa muaj para meje, të cilët më bënë të ndihesha sikur të isha në vendim tim. Po ashtu projektet në grupe dhe angazhimet e ndryshme në fakultet na bëjnë të njohim më mirë studentët irlandezë dhe të vendeve të rajonit dhe të shkëmbejmë dhe mësojmë informata të ndryshme".

Rineta thotë studimet master kërkojnë angazhim dhe koncentrim për t'i përmbyshur detyrat dhe obligimet tona si studentë të masterit dhe si duket ky mund të bëhet në shumtën e kohës ta kalojë në universitet duke punuar. Por as organizimet e ndryshme gjatë vikendeve dmth aktivitete sportive me kolegët vendas dhe

të huaj nuk mungojnë, gjë që na bën të ndihemi më të relaksuar. Pas përfundimit të studimeve master, do të kthehem në vendim tim të punoj, të kontribuoj dhe të angazhohem për një të ardhme më të mirë në aspektin edukativ-arkitekturor të vendit tim, thotë Rineta.

Lirigzona ndihet me fat që ka studiuar në UBT

Lirigzona Morina e la gojëhapur publikun finlandez me zërin e saj në shoun "Talenti multikulturor". Prej asaj konkurrence mjaft të gjerë ajo fitoi çmimin e tretë dhe si duket ky çmim znj. Morina ia hapi dyert në botën e muzikës dhe të kulturës në përgjithësi. Gjatë muajit shkurt, ajo mbajti koncert për të rinjtë e qytetit të Lappeenranta, kurse me ftesë zyrtare është e ftuar të bëjë hapjen e premierës së filmit "Vauhdin Hurma" ("Shpejto"), po ashtu në qytetin Lappeenranta.

"Nuk është e lehtë të depërtosh në një vend të huaj në botën e muzikës, mirëpo ndihem shumë e lumtur dhe e privilegjuar që profesionistët e muzikës në Finlandë po e vlerësojnë me të madhe talentin tim, dhe falë këtij vlerësimi korrekt më është bërë ftesa që ta hapi premierën e filmit "Vauhdin Hurma" dhe organizimeve të tjera për studentë", tha Lirigzona.

Lirigzona thotë se ka qenë me fat që ka filluar studimet në UBT. "UBT është institucion me vlera të mëdha evropiane dhe ndërkombëtare, i cili po ofron studime të kualitetit të lartë në vendin tonë. Këtë po e vërej kur po bëj krahasimin tim me

studentët ndërkombëtarë. Unë kam bërë zgjedhjen e duhur që kam vendosur të studioj në UBT, sepse kam përfituar shumë, njohuri, eksperiencë në fusha të ndryshme, bursë, si dhe tani bursën nga programi "Erasmus Mundus", që është mundësia më e mirë që kam mundur të fitoj ndonjëherë në jetë, dhe kjo është falë emrit dhe prestigjit që ka UBT dhe që ne si student e gëzojmë gjithashtu këtë prestigj si studentë të UBT-së", thotë ajo.

Porosia për kolegët e saj është që të përkushtohen sa më shumë në studimet dhe të zhvillojnë njohuritë e tyre, sepse është shumë e rëndësishme nëse dëshirojnë që me të vërtetë të kenë një të ardhme të ndritur. "UBT po ua ofron këtë mundësi në mënyrën më të mirë të mundshme, prandaj shfrytëzojeni".

Burimi: Puna profesionale në UBT, e njëjtë me universitetet botërore

Burim Ramadani studimet themelore i ka përfunduar në Fakultetin e Arkitekturës në UBT, dhe studimet master po i vazhdon në Universitetin e Limerickut, në Irlandë, në drejtimin e njëjtë. Ajo çka po më pëlqen në këtë universitet, sikurse në UBT edhe në UL, është mënyra e studimit që është shumë e mirë dhe profesionale, thotë ai.

Erodita: Nga UBT në "Free University" në Berlin

"Për mendimin tim UBT bën pjesë në universitetet më elite të rajonit dhe Evropës, gjë që nënkupton se ligjërimi dhe puna profesionale e këtij universiteti është në përputhshmëri me normat e edukimit të shumë universiteteve elite në Evropë. Një dallim që vlen të ceket është se ligjëratat në gjuhën gjermane ishin paksa sfiduese, por absolutisht të përbulluara", thotë Erodita Llugaxhiu, e cila vitin e tretë po e vazhdon në njërën ndër universitetet më prestigjioze në

Evropë, "Free University" në Berlin, Gjermani.

"Berlini është njëri ndër qytete më të bukura në Evropë, qytet të cilin çdo i ri dëshiron ta vizitojë, po ashtu edhe unë si e re kam pasur fatin të vijoj studimet në këtë qytet në Free University. Ligjëratat që i kam ndjekur në këtë universitet kanë qenë nga ligjërues të ndryshëm evropianë, ku edhe pse për një periudhë të shkurtër kohore kam pas mundësinë të mësoj shumë gjëra të rëndësishme në fushën e ekonomisë", thotë Erodita Llugaxhiu.

"Studentët në Free University vijojnë nga nacionalitete të ndryshme. Pata fatin dhe rastin të takoj shumë të rinj dhe njerëz nga vende të ndryshme të botës me vlera të mëdha akademike, të cilën do ta përcjell edhe pasi të largohemi nga Berlini".

Shkurta Berisha: Përkrahjen të madhe kanë nga profesorët e huaj

Shkurta Berisha, përveç që falënderon UBT për mundësinë për t'u bërë pjesë e Universitetit City, ajo thotë se në këtë universitetin përkrahje të madhe ka edhe nga profesorët që i ligjërojnë. Ajo thotë se këtu kemi pasur mundësinë të socializohemi me studentë të nacionaliteteve të ndryshme, të cilët nuk ndryshojnë shumë prej neve, pasi që prioritetet e dy palëve e kemi studimin. Ajo më tej shton se angazhimet për mësim janë të njëjta me ato në UBT dhe për studime Master nuk ka vendosur se ku do t'i vazhdojë, në UBT apo jashtë vendit. Shkurta Berisha dy vitet e para të studimeve themelore i ka përfunduar në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, kurse vitin e tretë në Universitetin City në Londër.

Harisi dhe Rina: Të fala nga City University

"Pas kalimit në vitin e tretë, u ofrua një mundësi e mirë, dhe thuhet mundësi për plotësimin e

një ëndrrë. Të studiosh në Londër! Pak e besueshme por e vërtetë! Oferta për një semestër studimi jashtë vendit, ishte ëndrra që të gjithë e dëshirojnë, e aq më shumë rinia. UBT e dha një mundësi të tillë. Takimi më botën e jashtme, pamja për së afërmi e një kulture tjetër, takimi më njerëz të ndryshëm, ballafaqimi i një realiteti tjetër, shfrytëzimi i literaturës nga profesor eminent botëror, e pasuron faktin se studentët të cilët studiojnë në UBT, janë studentë kualitativ, dhe të përgatitur mjaft mirë për jetën akademike, profesionale", shprehen Haris Haxhimehmeti dhe Rina Sadriu.

Faleminderit UBT! Faleminderit për plotësimin e ëndrrës. Të fala nga City University!

Agroni: Masterin në SHBA

Agron Krasniqi, vitin e tretë po e vazhdon në Universitetin e Limerickut, në drejtimin Menaxhment dhe Ndërmarrësi. Po ashtu, sikurse studentët e tjerë, edhe Agroni shumë shpejt është adaptuar me kolegët nga vende të tjera të botës. "Një gjë duhet ta cekim patjetër se shqiptarët në përgjithësi janë më të përgatitur dhe kanë njohuri nga kulturat dhe shkencat e ndryshme, ku me kombësi të tjera mund të flasësh vetëm në disa drejtime, ndërsa ne shqiptarët me plot kuptimin e fjalës dimë më shumë se këta, në qoftë se flasim për njohuri të përgjithshme".

Ai më tej shton se dita është ligji, sikur ligji që shkruhet dhe duhet respektuar, po ashtu edhe këtu çdo ditë i kemi detyrat e caktuara dhe duhet të jemi të saktë në këto detyra. Ndërsa në mbrëmje është pak më ndryshe, ku pothuajse çdo mbrëmje ka aktivitete të ndryshme kulturore dhe sociale. Dhe ka nata është më atraktive se sa në Kosovë. Po ashtu ai Agroni nuk bën ndonjë dallim mes ligjëratave në krahasim me UBT-në. Ai mendon se së shpejti do të diplomojë në studime themelore dhe do t'i vazhdojë studimet për master në ndonjë shtet tjetër, ku më së shumti e preferon SHBA-të.



Njomza e Blerta në Universitetin e Limerikut në Irlandë

"Arkitektura në Kosovë duhet ta zhvillojë identitetin e vet dhe, në anën tjetër, duke qenë në kontakt me zhvillimet ndërkombëtare. UBT na ofroi këto njohuri në bazë të cilësisë dhe stafit akademik. Jemi të privilegjuar që ishim pjesë e këtij universiteti ku morëm njohuritë themelore të arkitekturës", shprehen Njomza Havolli dhe Blerta Bytyçi Njomza Havolli dhe Blerta Bytyçi në UBT kanë studiuar në drejtimin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor. Në të njëjtin drejtim janë duke vazhduar studimet në Universitetin e Limerikut në Irlandë.

Në një bashkëbisedim për "UBT News" ato thonë se, si çdo student tjetër, kanë pasur vështirësi në fillim kur e kanë ndërruar ambientin, mirëpo tash janë adaptuar dhe ndjehen shumë mirë e nuk kanë telashe, kështu që presin se edhe në të ardhmen do të jetë kështu.

"Ditë dinamike, me shumë aktivitete gjatë tërë ditës, njohje të vendeve në rrethinë dhe duke shijuar bukuritë natyrore të Irlandës. Këto janë ditët e fillimit për neve. Sa i përket krahasimit me Kosovën, nuk mund ta krahasojmë, sepse Kosova është vendi ynë dhe kuptohet që kemi mall për të", shprehen ato. Duke folur për fushën e studimeve, ato shprehen se arkitektura pothuajse në të gjitha universitetet është e njëjtë. Gjatë tërë ditës me angazhime, me punime, me projekte dhe analiza të punimeve...

"Arkitektura në Kosovë duhet ta zhvillojë identitetin e vet dhe, në anën tjetër, duke qenë në kontakt me zhvillimet ndërkombëtare. UBT na ofroi këto njohuri në bazë të cilësisë dhe stafit akademik. Jemi të privilegjuar që ishim pjesë e këtij universiteti ku morëm njohuritë themelore të arkitekturës", shprehen Njomza dhe Blerta. Ato shtojnë: "Është një fat i madh që patëm rastin të jemi pjesë e këtij universiteti, i cili është një ndër universitetet më të mira në Irlandë, me profesorë-arkitektë nga e gjithë bota me kualifikime shumë të larta dhe me një qasje arkitektonike më të thelluar".

UBT ANËTARËSON SË SHPEJTI KOSOVËN EDHE NË ORGANIZATËN NDËRKOMBËTARE EUROSIM

Mars 2012 - Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, ka marrë pjesë në takimin vjetor të Organizatës EUROSIM, organizatë e cila merret me modelim dhe simulim.

Në këtë takim, z.Hajrizi ka paraqitur kërkesën që edhe Kosova, të bëhet anëtare e kësaj organizate, përmes KA-CASE dhe UBT- së.

Duke qenë pjesëmarrës në Këshillin vjetor të EUROSIM, Presidenti i UBT-së, dr. Hajrizi ka prezantuar punën e UBT-së, konferencat dhe takimet e tjera me karakter ndërkombëtar që ka organizuar UBT me mjaft sukses dhe duke mbledhur në Prishtinë emra të shquar të shkencës dhe ekspertë nga e gjithë bota.

Prezantimi i dr. Hajrizit u prit me mjaft interesim dhe ai shprehet shumë optimist dhe Republika e Kosovës, do të anëtarësohet edhe në këtë organizatë prestigjioze. Sipas tij, pas anëtarësimit në organizatën EUROSIM hapet një dritare për komunitetin akademik të UBT-së të cilët mund të marrin pjesë në konferencat shkencore që organizon EUROSIM, dhe në forume të tjera ndërkombëtare.

Kosova Association for Control Automation and Systems Engineering (KA-CASE), e përfaqëson Republikë e Kosovës në Asociacione ndërkombëtare shkencore dhe profesionale, e cila më konkretisht është themeluar dhe udhëhiqet nga Presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji UBT, Prof. Dr. Edmond Hajrizi.





Departamenti për Trajnime dhe Certifikime në UBT është shumë i angazhuar për të kontribuar në avancimin e shoqërisë kosovare në një shoqëri konkurrense, nëpërmjet trajnimeve tona profesionale, të cekura më poshtë:

Menaxhim

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- Administrim Biznesi
- Menaxhimi i Kualitetit (ISO 9001:2000)
- Menaxhimi Strategjik
- Ngritja (Themelimi) e ndërmarrjes së re
- Menaxhimi i Produktit
- Ndërtimi i Brendit
- Inxhinieringu Industrial
- Menaxhimi i Projekteve
- Menaxhimi i Proceseve
- Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit
- E-Biznes
- Transport dhe Logjistikë
- Sisteme Fleksibile të Prodhimit
- Prodhimi mbështetës
- Prodhim, Planifikim dhe Skedulim
- Menaxhimi i Ndryshimeve
- Menaxhimi i Rrezikut
- Menaxhimi i Ankesave
- Menaxhimi i Kohës
- Ndërmarrësi dhe Biznisplan
- Menaxhimi i Sistemeve Informativ
- Prokurimi
- Menaxhimi i Konfliktit
- Përgjegjësia Sociale e Korporatës
- Menaxhimi i Ngjarjeve
- Sistemet HACCP
- Fuzionimi dhe Bashkimi
- Planifikimi i resurseve të manufakturës
- Planifikimi i Materialeve të Kërkueshme (MRP)
- Shkathësi negocimi
- Menaxhmenti i Logjistikës

Financa

- Raportim Financiar i Korporatës
- Tregtia e Jashtme/Doganat
- Analiza e Kostove
- Kontabilitet dhe Menaxhim i Financave
- Vendimmarrja Financiare
- Institucionet Financiare dhe Tregjet

Marketing dhe Shitje:

- Marketing dhe Shitje
- Planifikimi i Burimeve të Shpërndarjes
- Mjetet e IT për Marketing

- Menaxhimi i Lojalitetit
- Merchandising
- Modeli i Optimizimit të çmimeve
- Zhvillimi i Produkteve dhe Brendimi
- Menaxhimi i Shitjes
- Shitja Efikase dhe Teknikat e Shitjes
- Menaxhimi i Ankesave të Konsumatorëve

Shkathësi kryesore të këshillimit:

- Menaxhimi Personal
- Komunikimi
- Punët e suksesshme grupore
- Grupimi dhe Krijimi i Grupeve
- Periodizimi
- Kodi i Etikës së Këshilltarit
- Zgjidhja e Konfliktit
- Negocimi i Kontratës
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientë
- Shërbime Këshillimi për Marketing
- Menaxhimi i Proceseve Këshilluese

Gjuhët e huaja:

- Gjuhë angleze
- Gjuhë gjermane
- Gjuhë frënge

Vërejtje e rëndësishme: Gjuhët e huaja, varësisht prej kërkesave të grupit në fokus, mund të mbahen edhe në bazë të kërkesave specifike të grupit për mësimin e terminologjive të ndryshme profesionale për gjuhët përkatëse

Drejtësi, Shkenca Politike dhe Diplomaci:

- Teknika Negocimi
- Zgjidhja e Konfliktit
- Aqvi Comunnitëre e Bashkimit Evropian
- Institucionet e Bashkimit Evropian
- Komunikimi Masiv
- Shkathësi Diplomatie
- State Protocol

Mekatronikë dhe Teknologji të tjera

- Mekatronikë (Pneumatikë, Elektro-Pneumatikë, E-Teknika / Programmable Logic Controllers (PLC), Hidraulikë, Elektro-Hidraulikë, Sistemet e Kontrollit Hidraulik, Sensorët
- Design Assembly & Mirëmbajtja e Sistemeve Mekatronike
- CAx - Teknologjitë (CAD/CAM, CAQ, CAP dhe CA të tjera)
- CNC-Teknikat
- Robotikë
- Teknika të Punës/ Organizim i Punës
- Mbrojtja e Mjedisit

- Teknika të Sigurisë për mbrojtjen së punëtorëve
- Dokumentimi Teknik
- Saldimi
- Inovimi

Teknologji Informativ

- CISCO
- IT Essencial
- CCNA Discovery 1.2.3.4
- CCNA Exploration 1.2.3.4
- ECDL
- Hardware
- Inxhiniering i Software (Gjuhët programuese dhe Bazat e të Dhënave)
- Rrjetizim
- Simulim i Kompjuterit
- Disenj Kompjuterik dhe Animacion
- Sisteme Aplikative të Ndërmarrjes
- Aplikime të Internetit
- Paketat CAD/CAM
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Konsumatorë (CRM)
- Modelimi, Optimizimi dhe simulimi

Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor

- Menaxhimi i Projekteve Konstruktuese
- Projektim me AUTO CAD, ARCHI CAD
- Materiale Konstruktuese dhe Kontroll Kualiteti
- Menaxhim Urban
- Certifikim për Kualitet
- Marketing në Arkitekturë

Trajnimet profesionale në disiplinat e lartcekura ofrohen në periudha të ndryshme, në bazë të kërkesës së individëve, institucioneve, kompanive dhe korporatave të ndryshme. Një grup profesionistësh vendorë dhe ndërkombëtarë, me përgatitje akademike superiore dhe përvojë të suksesshme, janë në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar një vistër të gjerë trajnimesh për një karrierë personale të avancuar dhe për sukses të padiskutueshëm të ndërmarrjes apo institucionit tuaj.

Vërejtje e rëndësishme: Ju lutemi, mos hezitoni të kontaktoni zyrtarin përgjegjës për Trajnime profesionale në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, përmes numrit të telefonit 038 541 400.

Kredi për studentë



**Raiffeisen
BANK**

...JETO MË MIRË

Financoni studimet tuaja

- Norma të volitshme interesi
 - 10,000 Euro deri në 5 vjet
 - 0% - shpenzime administrative

www.raiffeisen-kosovo.com
Raiffeisen Direct: 038 222 222

NJËSITË MATËSE NËPËR SHEKUJ

Në Konferencën e 19 të Përgjithshme për derhem dhe masa, më 1991, numri i parashtesave është shtuar për katër parashtesa të reja (zeta, joto, zapto dhe jokto) ashtu që tash ekzistojnë gjithsej 20 parashtesa SI (ndërkombëtare)

Prof.dr. Skënder Skënderi

Siç dihet, në kuadër të UBT funksionojnë pesë fakultete: Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Fakulteti për Shkenca Kompjuterike dhe Sistemet e Informacionit, Fakulteti për Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, Fakulteti për Inxhinieri, Fakulteti Juridik dhe Fakulteti për Shkencat Shoqërore; katër Institute: Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim, Instituti për Ndërmarrësi, Transfer të Teknologjisë dhe inovacione, Instituti për Gjuhë dhe Kompetencë ndërkulturore dhe Instituti për Studime Evropiane dhe Ndërkombëtare. Çka është shumë e rëndësishme, në UBT janë edhe këto laboratorë: Laboratori i Mekanikës dhe Robotikës, Laboratori i Teknologjisë së Informacionit, Laboratori për Multimedia etj. Kur shikohen përmbajtjet e lëndëve mësimore siç janë: Matja dhe ruajtja e Cilësisë, Standardet Ndërkombëtare dhe Evropiane, Matjet laboratorike etj. shihet serioziteti me të cilin merret ky Universitet. Kulmi dhe njëherësh baza e të gjitha arritjeve është shprehja e saktë e rezultateve të çfarëdo matjeje që bëhet. Cilësia e shprehjes së madhësive të matura sigurohet me standardet që janë përkufizuar me Sistemin Ndërkombëtar të njësive – SI të aprovuar nga të gjitha vendet e Botës që në vitin 1960 kur u themeluar ai me këtë emërtim i cili zhvillohet dhe përsoset në vazhdimësi. Saktësia e matjeve përcaktohet në laboratorët e avancuara që gjenden anë e mbanë vendeve të zhvilluara.

E gjithë kjo do të thotë se në UBT punohen shkencë ekzakte, të cilat kërkojnë studime ekzakte përmes analizave dhe shqyrtimeve

ekzakte, dhe më në fund kërkojnë matje ekzakte dhe rezultate ekzakte. Për ekzaktësi duhen matje ekzakte dhe shprehje ekzakte të rezultateve të matjeve. Meqenëse në shkencë, teknikë, teknologji dhe ekonomi bëhen zhvillimet globale botërore, andej paraqitja e të gjitha rezultateve, në fund, shndërrohet në matje e përcaktim të cilat duhet të konkretizohen në vlera të caktuara numerike dhe të shprehjen në njësi përkatëse. Për tu marrë vesh mes vete kultura e qytetërime të ndryshme me qëllim gërshtimesh të begative, duhet krijuar mënyra unike të matjeve dhe të shprehjeve të rezultateve me metoda unike. Në këtë mënyrë janë krijuar dhe krijohen standarde Ndërkombëtare sot shumë të njohura në të gjitha veprimtaritë njerëzore. Po si erdhi deri te kjo, të shikojmë përciptazi zhvillimet e matjeve dhe të njësive nga popujt e lashtë e deri më sot.

Njësiti e qytetërimeve të vjetra


Nuk do mend se njeriu i parë i cili ka krijuar diçka praktike nga gjërat përreth ka pasur nevojë për matjet e madhësive që i kanë hyrë punë. Për matje, siç shihet më tutje, njerëzit kanë zgjedhur ndonjë gjymtyrë të vetën siç është gisht, pëllëmba, këmba, bërryli, hapi, pashi etj. Më vonë kanë zgjedhur dukuritë më të njohura natyrore siç është lëvizja e Hënës dhe e Diellit rreth Tokës për të matur kohën e kështu me radhë. Sa për kureshtje do t'i shikojmë njësiti e disa civilizimeve që kanë lënë gjurmë të thellë në matje dhe njësiti matëse e që përdoren edhe sot. Natyrisht, në këto procese kanë hyrë edhe të parët tanë.

Njësiti e vjetra babilonase

1 bërryl	= 30 gishta	= 51,72 cm
1 tjegull	= 19 gishta	= 32,3 cm
1 këmbë	= 16 gishta	= 27,58 cm
1 dorë	= 4 gishta	= 6,9 cm
1 gisht	=	= 1,72 cm

Sipas shkrimeve dhe gërmimeve arkeologjike, del se Babilonasit kanë qenë civilizimi i parë që kanë pasur sistem unik të matjeve të cilin

e ka shpallur Sunduesi. Është zbuluar një thupër nga bakri, që mendohet të jetë ndërtuar 2000 vjet p.e.r. me gjatësi 110,35 cm. Kjo thupër është e ndarë në 6 pjesë distanca e të cilave saktësisht paraqet njësi të plota të shprehura në njësiti: *gisht, dorë, këmbë, tjegull* dhe *bërryl*, sipas figurës në vijim.



Vizatimi i shkopyt nga bakri i ndërtuar 2000 vjet p.e.r. në Babiloni i cili paraqet njësi të atëhershme të gjatësisë. Thupra duhej të shërbente për matjet e gjatësive, dhe me gjasa ka qenë e vendosur në ndonjë tempull apo vend tjetër publik ku kanë mundur të shërbehen me të tregtarët dhe të interesuar të tjerë.

Njësiti e vjetra egjiptiane

Matjet e para në Egjipt mendohet të jenë bërë rreth 3500 vjet p. e. r. Arsyeja e matjeve ka qenë shfrytëzimi i fushave me sipërfaqe të madhe të cilat kanë qenë periodikisht të vërshuara nga lumi Nil, me ç' rast janë bërë ndryshime të shumta e të theksuara të reliefit të sipërfaqes. Pas çdo vërshimi është dashur ri përcaktimi i kufijve të pronave dhe kjo ka kërkuar shpejtësi për të mos humbur kohë në mbjelljet e fushave.

Për këtë arsye, Egjiptianët e vjetër kishin krijuar mjete, metoda dhe njësi matjeje mjaft të avancuara dhe të sakta. Si pajisje për matjen e gjatësisë përdornin shiritin, ndërsa si njësi për matjen e gjatësisë kishin përcaktuar njësinë e quajtur *bërryl*. Bërryli mbretëror kishte gjatësinë 52 cm ndërsa bërryli i vogël kishte gjatësinë 45 cm. Gjerësia e gishtit të madh quhej *zebo* që lidhej me këto njësi sipas tabelës në vijim:



Shënimi i një matjeje në hieroglif

Në këtë vizatim të lashtë egjiptian të bërë në pergamenë, shihet përdorimi më i hershëm i veglës për matjen e masës – kandari. Vegla për matje është një lloz me krahë të njëjtë, i varur në mjedis në kornizën prej druri. Në të dy skajet e llozit janë varur nga një enë: njëra për mbajtjen e arit, ndërsa tjetra për vënien e masave për matje. Mendohet që në këtë figurë të jenë paraqitur argjendarët duke matur arin.

Nga hieroglifi mbi vizatim mësojmë se llozi është ekuilibruar, personi në anën e majtë thotë "*Shiko*", ndërsa personi në anën e djathtë me ngritjen e dorës aprovon rregullsinë e matjes. Ky lloz me gjatësi 45 cm me nga 0,5 kg në secilën enë, ka pasur saktësinë 6,5 g. Në dokumente të asaj kohe dihet se ka ekzistuar mashtrimi gjatë matjeve. Në brendinë e krahut të llozit për ekuilibrim është futur mercuri. Dihet se Egjiptianët kanë paraparë ndëshkime të ashpra për këso mashtrimesh. Rregullsinë e mjeteve për matje e ka kontrolluar shërbimi i tarimeve të faraonëve që ka pasur rrjet të gjerë.

Njësiti e vjetra greke

Në Greqinë e vjetër matjet dhe masat kanë qenë në shërbimet shtetërore. Mashtrimet e bëra në lidhje me matjet dhe masat janë ndëshkuar shumë ashpër. Inspektorët e matjeve janë quajtur *metronomus*. Shumicën e njësive Grekët i kanë huazuar nga Egjiptasit, por më vonë e kanë përsosur dhe zhvilluar në nivel shumë më të lartë. Njësiti greke më vonë janë përvetësuar nga Romakët. Vetë fjala matje rrjedh nga fjala greke *metron* - □□□□□□□□□□ që do të thotë masë për matje.

Për masat greke kemi të dhëna të sakta: p.sh. këmba e vjetër greke ka qenë e gjatë 30,83 cm, rreth 1% më e madhe

se këmba e sotme anglo-amerikane, *stadia* vjetër grek ka qenë 600 herë më i madh se këmba. Njësia athinase e gjatësisë *stadia* ka pasur 500 këmba athinase që kanë pasur gjatësinë nga 32,8 cm. Edhe Grekët kanë pasur njësiti: *gishti, pëllëmba, bërryli* dhe disa njësi tjera më të mëdha e më të vogla. Njësia e sipërfaqes ka qenë *plethron*, e cila ka përmbajtur 10 000 këmbë katrore, përafërsisht rreth 950 m².

Pasi matjet e masave në Greqinë e Vjetër kanë qenë shumë të zhvilluara, për derhem janë përdorur *talento* të ndryshëm (*talenton* – □□□□□□□□ do të thotë balancim). Talenti më i vogël ka qenë *talenti sirian* apo *talenti i Ptolomeit* (rreth 7 kg), ai mesatar *talenti athinas* (26,196 kg) dhe më i madhi *talenti i ri grek* (150 kg). Krahas këtyre ka pasur edhe një seri derhemësh që në mes vete kanë qenë në këto përpjesa: 1/6 : 1 : 100 : 6000 apo 1 : 60 : 6000 : 36000. Emërtimet e këtyre derhemëve njëkohësisht kanë qenë edhe emërtimet e monedhave metalike. Barnatoret kanë pasur sistem të veçantë të derhemëve, në mes të të cilëve është edhe *unça*, të cilën sot e njohim si *unca* te anglo-amerikanët. Edhe njësia *libra* ka qenë me prejardhje greke. Po ashtu edhe veterinarët kanë pasur derhemët e vet për matjen e derhemëve të kafshëve. Po ashtu, lëngjet i kanë matur me një lloj masash, prodhimet bujqësore me të tjera, prodhimet e ngurta me të tjera etj. Në jetën e përditshme dhe në tregti një numër kaq i madh masash ka sjell kokëçarje dhe vështirësi, ngjashëm me atë që kemi sot me njësiti anglo-amerikane. **Njësiti e vjetra romake** Rreth vitit 300 të epokës së re Romakët i kanë përdorur njësiti greke por i kanë pasur edhe sistemet e derhemëve të matjes si dhe njësiti e veta.

Shkopinjë e normuar i

kanë ruajtur si hyjni në Kapitol, ndërsa kopjet e tyre i kanë ndërtuar në muret e ndërtesave me qëllim që me to të shërbehen qytetarët. *Këmba romake* ka qenë e gjatë

MODELE PËR PËRSHTATJETË CAPM TRADICIONAL NË KUSHTET E TREGJEVE NË ZHVILLIM

ICAPM bazohet në modelin tradicional të kostos së mjeteve kapitale, por përmban edhe supozimin se tregjet botërore janë në mënyrë perfekte të integruara. Nëse investitorët mund të investojnë në cilindo treg, risku i përcaktuar i lidhur me vende të caktuara dhe regjione mundet të diversifikohet dhe i vetmi rrezik që do të mbetet është risku josistemik i portfolios botërore

Bukurie Imeri-Jusufo

1. Modele për koston e kapitalit në vendet në zhvillim

Për përcaktimin e koston së kapitalit në vendet në zhvillim janë propozuar modele të ndryshme nga akademikë dhe praktikantë. Nuk e ekziston konsensus në raportin kush janë implikacionet e vërteta për vendet në zhvillim në preminë e kërkuar të riskut të kapitalit. Në vazhdim janë të paraqitur disa modele, me sqarime të shkurtra për përparësitë dhe mangësitë e tyre.

1.1 Vrojtimi direkt i tregut lokal. Përfshin analiza të kushteve për tregtim lokal në vend, që është objekt vrojtimi. Përparësia e këtij modeli është mundësia i vrojtimit direkt të karakteristikave të kthimit të tregut konkret. Mangësia kryesore është se për ta aplikuar duhen numër i madh i të dhënave historike për të përcaktuar preminë e riskut të tregut në periudha më të gjata kohore. Të dhënat e këtyra nuk mund të jenë të disponueshme në tregjet në zhvillim. Aplikimi i vrojtimit direkt i premisë për risk të tregut nuk është i përshtatshëm për aplikim në Maqedoni dhe Kosovë.

1.2. Modeli ndërkombëtar për vlerësimin e mjeteve kapitale (ICAPM). ICAPM bazohet në modelin tradicional të kostos së mjeteve kapitale, por përmban edhe supozimin se tregjet botërore janë në mënyrë perfekte të integruara. Nëse investitorët mund të investojnë në cilindo treg, risku i përcaktuar i lidhur me vende të caktuara dhe regjione mundet të diversifikohet dhe i vetmi rrezik që do të mbetet është risku josistemik i portfolios botërore.

$$r_e = r_f + \beta_w * ERP_w$$

Modeli funksionon për tregjet e integruara, por për tregjet e segmentuara, siç është rasti i vendeve në zhvillim, modeli nuk arrin që në mënyrë të drejtë të vlerësojë riskun dhe nënvlerëson vlerën e kthimeve të kërkuara. Për këtë arsye vlerësojmë se ky model nuk është i përshtatshëm për Maqedoninë.

1.3. CAPM modeli- globalisht i mbrojtur. Për dallim nga ICAPM në këtë model përka riskut botëror, përfshihet edhe risku regjional dhe ai i vendit. Tregueset për segmentimin e regjionit dhe të vendit në raport me botën përlllogariten me regresion të kthimeve të tepërta të regjionit në krahasim me kthimet e tepërta të botës dhe me regresion të kthimeve të tepërta të vendit në raport me preminë regjionale të riskut në krahasim me kthimet e tepërta të botës. Përparësi e modelit është se ai merr parasysh riskun e regjionit dhe të vendit por kërkon të dhëna për tregun e regjionit dhe të vendit që ti mundësohet njehsimi i koeficienteve me regresion. Vlerësojmë se nuk ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme për aplikim të këtij modeli.

1.4. Modeli i margjinave të vendit. Modelet e margjinave të vendit janë mjaft të njohura dhe gjerësisht të zbatueshme në praktikë. Këto modele zbatohen formulën:

$$r_e = r_f + \beta_w * ERP_w + \text{premia e riskut e vendit}$$

Modeli e shton preminë e riskut të vendit në koston e kapitalit të përcaktuar mbi bazën e instrumenteve të maturuara të tregut më shpesh në SHBA (siç është rasti edhe në formulën konkrete). Modeli aplikon normë të "pjekur" pa risk dhe premi të riskut të kapitalit, ndërsa β përcaktohet në raport me portfolion e tregut lokal. Variabeli i rëndësishëm dhe subjektiv në barazimin e mësipërm është njehsimi i premisë së riskut të vendit, për çka ekzistojnë më tepër modele të propozuara. Metodë e zakonshme për njehsimin e premisë të riskut të vendit është përdorimi i margjinave për mospagesën, e cila zakonisht njehsohet si diferencë midis normave të obligacioneve shtetërore të denominuar në dollar dhe obligacioneve shtetërore amerikane. Një alternativë tjetër është që të kryhet vlerësimi i nivelit të riskut të vendit në përmjet analizës të treguesve themelor të vendit dhe krahasimi i tyre me tregjet e integruara dhe stabël. Në lidhje me kuptimin e shkallës së integritit e rëndësishme është që të kemi parasysh ndikuesit: vlerësimi i kapitalizimit të tregut, vlerësimi i investimeve të huaja, vlerësimi i likuiditetit të tregut të letrave me vlerë. Mendojmë se ekziston një subjektivitet i rëndësishëm te ponderët e përdorur në këtë metodë dhe për këtë arsye kjo metodë nuk është adekuate.

Damodaran gjithashtu propozon përshtatje të mëtutjeshme të modelit bazë të përcaktimit të riskut të vendit, sipas modelit, premia e riskut të vendit në mënyrë të barabartë ndikon në të gjitha firmat që veprojnë. Damodaran thekson se kjo nuk është gjithmonë e vërtetë dhe propozon përfshirje të disa faktorëve të veçantë që do të mundësojnë ndikim të ndryshëm të riskut të vendit mbi tipe të ndryshme vepërimitarish. Damodaran propozoi këto modele themelore:

1. Formula në vijim supozon se ekspozimi i firmës ndaj riskun e vendit është proporcional me risqet e tjera.

$$r_e = r_{f,SH} + \beta_{e,SH} * (MRP_{SH} + CRP_{country}) \quad (1)$$

2. Formula (2) jep modelin që tregon se të gjitha firmat në mënyrë të barabartë ekspozohen ndaj riskut të vendit:

$$r_e = r_{f,SH} + \beta_{e,SH} * (MRP_{SH}) + CRP_{country} \quad (2)$$

3. Modeli që paraqet faktin se ekspozimi i firmave ndaj riskut të vendit është i ndryshëm dhe nuk është proporcional me risqet e tjera, jepet me formulën:

$$r_e = r_{f,SH} + \beta_{e,SH} * (MRP_{SH}) + \lambda * CRP_{country} \quad (3)$$

Meqenëse përdorimi i formulës (3) kërkon vlerësime më të detajuara dhe më subjektive, prandaj propozojmë përdorimin e formulës (2). Përparësi e kësaj metode është se edhe norma e joriskut edhe premia e riskut të kapitalit i përcakton nga një treg i zhvilluar, i cili ka një numër të konsiderueshëm të serive historike të të dhënave dhe studime akademike, që shërbejnë si burime të të dhënave. Beta, njehson në pajtueshmëri me tregun lokal, në përgjithësi është e vështirë të përcaktohet për vendet në zhvillim, për shkak të qasjes deri te

numër i kufizuar i të dhënave, si do që të jetë beta mund të vlerësohet në pajtueshmëri me firma të krahasueshme.

1.4. Modeli i shmangies standarde relative. E vlerëson preminë e riskut të kapitalit të një tregu stabël me shmangien standarde relative të atij tregu kundrejt të njëjtës së tregut stabël. Përdoret formula:

$$ERP_{vendi} = ERP_{SHBA} * SHS \text{ relative e vendit}$$

Ku:

$$SHS \text{ relative e vendit} = \frac{SHS \text{ e vendit}}{SHS \text{ e SHBA}}$$

Një qasje e tillë kërkon njehsimin e shmangies standarde të dy tregjeve të kapitalit. Përderisa shmangia standarde për vendet e zhvilluara në përgjithësi është e aksesueshme, e njëjta nuk mund të thuhet për vendet në zhvillim, pra nuk kemi akses të lehtë. Një e metë tjetër e modelit është që në rast të një tregu jolikuidues, shmangia standarde mund ta ulë jostabilitetin dhe në këtë mënyrë ta nënvlerësoj preminë specifike të riskut të kapitalit të ndonjë vendi.

Nuk preferohet aplikimi i këtij model.



Bukurie Imeri – Jusufi, ligjëruese në Fakultetin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT). Studimet themelore dhe magjistraturës i ka përfunduar në Universitetin e Shkupit, kurse studimet e doktoratës po i vazhdon po në të njëjtin Universitet, e përcaktuar për temën "Shmangja e vlerës kontabël nga vlera e tregut e kompanive që kotojnë në bursën e Maqedonisë në krahasim me kompanitë që kotojnë në bursat e Evropës Juglindore", nën udhëheqjen shkencore të Prof. Dr. Biljana Angelova. Është njohëse e gjuhëve sllave, angleze dhe frënge. Ka qenë pjesëmarrëse e konferencave dhe seminareve të shumta shkencor. Ka dy botime në revista më renomene ndërkombëtare "RM state debt before and after the 2008 financial crisis, -"Konferenca e Ekonomisë" e ALB-SHKENCA, në bashkëpunim me Prof. Dr. Biljana Angelova, dhe "Models to fit the traditional CAPM's in terms of emerging markets-"Konferenca e Ekonomisë" e ALB-SHKENCA, të publikuara në vitin 2011.

NIS IMPLEMENTIMI I MARRËVESHJES MES UBT-së DHE UNIVERSITETIN PARTHENOPE TË NAPOLIT

Prishtinë, 22 mars 2012- Ka filluar zbatimimi i marrëveshjes së bashkëpunimit mes Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT) dhe Universitetit Parthenope në Napoli të Republikës së Italisë, nënshkruar muaj më parë.

Fillimisht, në bazë të marrëveshjes së arritur, të dy universitetet do të zhvillojnë projekte të përbashkëta hulumtuese në fushën e përgjegjësive sociale, produkteve vendore, kryesisht në sferën e ekonomisë, projekte për të cilat ka shumë nevojë, sidomos në vendin tonë, por edhe përmes të cilave studentët marrin përvojat pozitive nga ekonomia evropiane.

Në këtë projekt, përveç tjerave do të ketë edhe hulumtime tjera të involvura edhe

Republika e Italisë dhe universitete tjera partnere.

Marrëveshja mes UBT-së dhe Universitetit Parthenope mundëson bashkëpunimin ndëruniversitar në të gjitha nivelet e studimit e sidomos në fushën e doktoratës. Po ashtu, ajo parasheh shkëmbimin e stafit akademik dhe të studentëve, organizimin e seminareve dhe takimeve të tjera akademike për çështje shkencore, përdorimin e bibliotekave përkatëse për nevoja të studimeve dhe hulumtimeve shkencore, programet e studimit në distancë, zbatimin e përbashkët të programeve postdiplomike, aktivitete lidhur me kurset verore dhe takime të tjera akademike për çështje të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet.



UBT DHE DANUBE UNIVERSITY KREMS ORGANIZOJNË KONFERENCË SHKENCORE NË FUSHËN E ENERGJISË



Mars 2012 - Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) dhe Danube University Krems vazhdojnë edhe më tej implementimin e marrëveshjes së tyre të bashkëpunimit.

Gjatë një takimi të udhëheqësve të të dy institucioneve u vendos që në muajin shtator të këtij viti, të dyja institucionet universitare të organizojnë një konferencë shkencore në fushën e energjisë, e cila do të mbahet në Kosovë.

“Gjatë takimit me menaxhmentin e lartë të Danube University Krems, kemi shprehur

gatishmëri për bashkëpunim të mëtutjeshëm e sidomos në fushat e projekteve të tjera hulumtuese dhe shkencore. Në një të ardhme të afërt bashkërisht do të aplikojmë për projekte, grante dhe në konferenca shkencore”, tha Presidenti i UBT, Dr. Hajrizi.

UBT ka marrëveshje bashkëpunimi me Danube University Krems që nga viti 2010 dhe falë këtij bashkëpunimi për herë të parë në Kosovë e më gjerë, Danube University Krems ofron programe për studime Master në fushën e Administrimit të Biznesit dhe me bursa mbi 50% të shumë të studimeve.

UBT DHE ZYRA E UNICEF-it REALIZOJNË PROJEKTE TË PËRBASHKËTA

Prishtinë, 21 mars 2011 – Një varg nismash, kryesisht me karakter për të ndihmuar të rinjtë dhe për të krijuar kushte më të mira biznesi dhe jete për ta, janë pjesë e marrëveshjes mes Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT) dhe Zyrës së UNICEF-it në Kosovë.



forcur dhe aftësuar kapacitetet e rinisë së Kosovës për zhvillimin e zgjidhjeve të problematikave aktuale, si aftësimin e të rinjve për të iniciuar investime në biznese aktuale të nevojshme lokale për një të ardhme më të mirë dhe të sigurt në të gjitha fushat e jetës.

Marrëveshja e nënshkruar mes Presidentit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe zëvendëshefit të UNICEF-it, zyra në Kosovë, Luciani Caletini, më konkretisht parasheh aktivitetet për të

Laboratori i UNICEF-it ka hulumtuar probleme nga më të ndryshmet për rininë dhe me fëmijët e Kosovës, ndërsa studentët dhe stafi i UBT-së po kontribuojnë në realizimin e projekteve të propozuara në vazhdimësi nga UNICEF-i.



DR. HAJRIZI KA MARRË PJESË NË PANAIRIN PËR EDUKIM NË AUSTRI

Mars 2012 - Pas panairit në Hanover të Gjermanisë, presidenti i UBT-së, dr. Hajrizi ka marr pjesë edhe në Panairin për Edukim, që është mbajtur në Vjenë të Austrisë. Në këtë panairi i pari i UBT-së dr. Hajrizi ka zhvilluar një varg takimesh me udhëheqës të universitete të ndryshme austriake dhe ndërkombëtare, ku është biseduar për programet e ndryshme të studimeve, projekte hulumtuese dhe zhvillimore.



OCDE BASHKËPUNON ME UBT-në

Mars 2012 - Një delegacion nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OCDE) me seli në Paris takuan presidentin e UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, dhe vizituan UBT me qëllim bashkëpunimi në fushën e inovacioneve.

Pala mysafire u ndanë shumë të kënaqur me të arriturat e UBT-së dhe panë shumë elemente konkrete inovative, në programe e politika të UBT-së.

Ky delegacion, të njëjtën kohë të parin e UBT-së dr. E. Hajrizini, e propozuan si anëtar të grupit punues të organizatës OCDE për Kosovën, për hartimin e strategjisë së inovacionit.

PROFESORËT PËR "UBT NEWS"

GAZETA E STUDENTËVE, UD

"Gazeta e UBT-së është një ndër mjetet kryesore të komunikimit të universitetit me të gjitha palët e interesit që zhvillimet në UBT i ndjekin me interes të veçantë. Unë personalisht, me vëmendje e përcjell secilin edicion që botohet dhe mund të theksoj që jam jashtëzakonisht i kënaqur me të gjitha rubrikat e shkruara e posaçërisht më interesojnë ato që paraqesin sukseset akademike dhe profesionale të studentëve, alumnit apo stafit akademik të UBT-së"



Prof. Dr. Kozeta Sevrani

Në dhjetor të vitit 2010 m'u desh të vizitoja për herë të parë Universitetin për Biznes e Teknologji në Prishtinë, pas një marrëveshjeje për bashkëpunim me presidentin e këtij Universiteti të nderuar, prof. Edmond Hajrizi. Atë ditë ishte parashikuar që të mbaja një ligjëratë mbi rolin e Sistemeve të Informacionit në marketing me studentët e masterit. Sapo hyra në ambientin e Universitetit, kontakti i parë që më një tufë gazetash të vendosura mbi tavolinat e ambientit hyrës. Ishte gazeta që mbante titullin "UBT News"... U bëra kureshtar për ta shfletuar, ndërkohë që përgatitesha për të mbajtur ligjëratën. Më bëri përshtypje jo vetëm shumëllojshmëria e rubrikave që trajtoheshin, por dhe mënyra e paraqitjes më shumë shije dhe kulturë, me profesionalizëm dhe stil të shkruari mjaft të veçantë i aktiviteteve të organizuara nga UBT, por dhe me tej. Fillova ta shfletoj faqe pas faqe dhe kuptova se me sa përkushtim ishte realizuar kjo gazetë. Qe nga ajo kohë, sa here bie në kontakt me faqet e saj, nuk lë rast pa e lexuar. Tashme ajo është kthyer në një gazetë të dashur për lexuesit, jo vetëm për ata lexues që i përkasin UBT.

Sa here që vi në UBT për të mbajtur ligjëratat e mia, nuk harroj ta marr me vete kopje të kësaj gazete, të cilat i lexoj kur kthehem në Tiranë. Gazeta është një paraqitje dinjitoze e një universiteti dinjitoz siç është UBT. Duke i uruar sa më shumë sukses kësaj gazete, mendoj se ajo mund të shtoj sasinë e botimeve, pasi ka shtuar në mënyrë të konsiderueshme rubrikat që lidhen me aktivitetet e UBT-së, por dhe më tej. Mezi pres të lexoj numrin e ardhshëm të "UBT News"!



Dr. cand. Artion Celina

Gazeta e UBT-së është një ndër mjetet kryesore të komunikimit të universitetit me të gjitha palët e interesit që zhvillimet në UBT i ndjekin me interes të veçantë. Unë personalisht, me vëmendje e përcjell secilin edicion që botohet dhe mund të theksoj që jam jashtëzakonisht i kënaqur me të gjitha rubrikat e shkruara e posaçërisht më interesojnë ato që paraqesin sukseset akademike dhe profesionale të studentëve, alumnit apo stafit akademik të UBT-së.

Mbi të gjitha, mendoj që kjo gazetë duhet të zgjerohet me fusha të ndryshme të informacionit të dimensionet nacional ku kjo gazetë do të ishte e pranishme tek lexuesit edhe jashtë UBT-së dhe të trajtonte shkrime të ndryshme nga fusha e biznesit dhe teknologjisë, pra fusha këto ku UBT ka dëshmuar ekspertizën dhe traditën.



Dr. cand. Besim Limani

E lexoj dhe e përcjell me kujdes gazetën "UBT News" dhe kam respekt për stafin si dhe për

punën që e bëjnë në këtë gazetë. Mendimi im personal është që kjo gazetë ofron informacione të dobishme për fushat e prezantuara si për studentët ashtu edhe për stafin e UBT-së.

Më pëlqejnë sidomos informacionet që përmbajnë të arriturat e studentëve dhe të ish-studentëve të UBT-së.

Të ardhmen e kësaj gazete e shoh në prizmin e një gazete që del më shpesh, me informacione në fushën e teknologjisë më të fundit si dhe të trendëve të reja nga fusha e teknologjisë dhe biznesit në nivelin botëror edhe atë kosovar e kombëtar.



Besnik Skënderi

Gazeta "UBT News" është një gazetë interesante dhe për dallim prej gazetave ditore në Kosovë, kjo mund të lexohet për një periudhë më të gjatë kohore.

Me këtë gazetë, studentët, profesorët dhe sponsoruesit e studimeve (prindërit) mund të njoftohen me të arriturat e UBT-së si dhe me mundësitë për ngritje profesionale që i ofron UBT për studentë dhe për profesorë.

Kjo revistë mund të përdoret edhe nga punëdhënësit të cilët mund të informohen dhe ta shohin profilin e studentëve të dalluar dhe në këtë mënyrë mund të rekrutojnë edhe profesionalistë të sapo diplomuar.

PH.D. cand. Bukurie Imeri-Jusufi

Për herë të parë kur hyra në Universitetin UBT si mësimdhënëse, më bëri përshtypje rregullshmëria, informimi i studentëve që u bëhet nëpërmjet recepcioni dhe ekranin, por



mbi të gjitha me beri përshtypje informimi i studentëve dhe stafit akademik për te rejat në lidhje me Universitetin nëpërmjet gazetës "UBT News". Prandaj u bëra kurioze dhe fillova të jem edhe unë lexuese e rregullt e kësaj gazete. Po ashtu më pëlqejnë gati të gjitha rubrikat, por do të kisha veçuar këtu rubrikat: mbi të arriturat e Universitetit, mbi të arriturat e studentëve që kanë dalë nga UBT ose për ato që vazhdojnë të jenë pjesë e këtij Universiteti, mbi të arriturat shkencore të mësimdhënëseve të UBT etj. "UBT News" është gazetë që trajton problemet e arsimit të lartë në përgjithësi dhe në veçanti trajton zhvillimin dhe konsolidimin cilësor të Universitetit UBT, një gjë e mirë është ndoshta se në këtë gazetë nuk gjenden aspak politikë, që në të kundërt gazetave ditore janë të stërmbushura me politikë.

Nuk mendoj se do të ishte e nevojshme që të bëhet gazetë ditore për informim të përgjithshëm të popullatës, por besoj se duke ruajtur karakterin që ka kjo gazetë, në të ardhmen mund të bëhet një gazetë mbarëkombëtare studentore - e arsimit të lartë, ku do trajtoheshin problemet e studentëve, problemet e arsimit të lartë nëpër trojet shqiptare dhe më gjerë dhe të përmbajë edhe lajme të tjera. Një gazetë e tillë besoj se do të afrohet studentet midis veti, do të rrisë bashkëpunimin midis Universiteteve me synim rritjen e cilësisë.

Uragan Aliu

Në kohën që po jetojmë, ballafaqohemi me qasje në informata të shumta të cilat shpeshherë edhe humbin vëmendjen tonë. Sipas disa hulumtimeve të ndryshme, njerëzit ballafaqohen me mbi 5000 lloje të ndryshme të komunikimit brenda vetëm



një javë. Shpeshherë, qasja në informata është e lehtë, po gjetja e informatës së duhur në kohën e duhur është një prej sfidave të kohës të cilën po e jetojmë.

Mendoj se gazeta "UBT News" është një format informativ jashtëzakonisht i pasur me informata të ndryshme lidhur me institucionin, aktivitetet e saja akademike dhe alumnit i cili është në rritje të madhe dita ditës. Kjo gazetë, mendoj se është një burim jashtëzakonisht i mirë për tu informuar me detaje me të gjitha aktivitetet në UBT, si dhe një mundësi e mirë për të mësuar më shumë edhe për përshtypjet e të tjerëve lidhur me UBT, në këtë rast studentët apo edhe të profesorëve vizitor nga universitetet tjera.

Prej pjesëve që më shumti më pëlqejnë në këtë gazetë është përmbledhja e aktiviteteve që ndodhin në UBT gjatë periudhës të cilën e përfshin gazeta dhe hapësira për studentët ku mund të shpalosin idetë dhe mendimet e tyre për çështjet e ndryshme me interes.

Sa i përket qasjes në gazetë, mendoj se UBT mund të konsideroj edhe mundësinë e shpërndarjes së gazetës edhe tek institucionet tjera në të cilat ka interes për të mësuar më tepër lidhur me atë që ndodh në UBT. Pasi që formati i gazetës është kryesisht në gjuhën shqipe, pse jo që "UBT News" të mos jetë në dispozicion në të gjitha vende ku flitet gjuha shqipe.

Ju përgëzoj për punën e bërë dhe ju dëshiroj suksese!

Mentor Geci

Gazeta "UBT News" padyshim se paraqet një dritare të rëndësishme të informimit në UBT. Prej numrit të parë e deri më tani, informatat e publikuara në

UDHËRRËFYES PËR TË GJITHË



shumë artikujve me përmbajtje të përgjithshme të çështjeve vendore por edhe atyre ndërkombëtare si dhe temave specifike të arritjeve shkencore. Ajo që mua më bënë përshtypje është trajtimi i temave që kanë të bëjnë me zhvillimin vendor ku i lihet hapësirë e veçantë promovimit të prodhimit vendor, e cila është shumë e rëndësishme. Duke e parë zhvillimin e kësaj gazete brenda këtyre viteve, mendoj se do të mund të zgjeronte shtrirjen dhe rritjen e lexuesve edhe jashtë UBT-së.

Ermal Lubishtani

“UBT News” për çdo numër po na befason për të mirë, me materialet e larmishme dhe profesionale si dhe me qasjen e trajtimit të dukurive dhe fenomeneve që aktualisht po ndodhin në shoqërinë tonë. Fjala e lirë dhe shtypi i pavarur, profesional dhe i paanshëm, ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e një shoqërie të shëndoshë. Konsideroj që këtë mision të shenjtë gazetaresk me shumë sukses është duke e jetësuar gazeta “UBT News”.

hulumtuese që bëhen në këtë gazetë nuk i shoh në shtypin tjetër. Lexuesit janë lodhur nga gazetët “ekskluzive”, me lajme bombarduese, qëllimkëqija, fyese dhe acaruese. Kemi nevojë për gazetë reale, afirmuese dhe korrekte siç është “UBT News”.

atë gazetë, përfshirë edicionin mbi 10- vjetorin e UBT-së, tregojnë një ngritje në sasi dhe cilësi të artikujve të shkruar në të.

Rubrika që e preferoj nga kjo gazetë është ajo mbi artikujt shkencor të publikuar qoftë nga stafit akademik, qoftë nga studentët e UBT-së. Mendoj që publikimi eventual në baza më të shpeshta periodike se sa që është tani, do të paraqiste një devijimin në krahasim me qëllimin parimor të saj.

Pa dyshim se “UBT News” nuk është gazetë ditore. Ajo që kisha propozuar të shtohet është numri i artikujve shkencor, e sidomos nga bashkëpunimi staf akademik - student. Bazuar në trendin e zhvillimit të saj, besoj që në një të ardhme të afërt kjo gazetë do të ketë epitetin e gazetës ndërkombëtare.



Nami Zeqiri

Gazeta “UBT News” jo vetëm që po shërben si udhërrëfyes për shumë aktivitete që ndodhin në UBT por në shumë raste shërben edhe si mjet i mirë për të treguar rezultatet dhe të arriturat e studentëve, profesorëve dhe gjithçka tjetër që lidhet me këtë institucion të lartë arsimor.

Si lexues i rregullt i gazetës “UBT News” mbetem i kënaqur me nivelin e përgatitjes së kësaj dritare të informimit megjithatë sugjeroj që në gazetë të publikohen edhe disa nga punimet dhe të arriturat e veçanta dhe të vlerësuara të studentëve.



Muzafer Shala

Jam lexues i rregullt i gazetës “UBT News” dhe kam fjalë miradije për faktin se kjo gazetë ka një dizajn të mirë. Kjo gazetë është e paanshme dhe nuk është e rrehtuar në ndonjë subjekt politik. Me distribuimin e temave e materialeve interesante për lexuesit e te gjitha moshave besoj që së shpejti do arrijë të jetë gazeta me e lexuara jo vetëm në Kosovë por në të gjitha trevat shqipfolëse.



Muhamet Ahmeti

Gazetën “UBT News” e lexoj me ëndje, sepse dallohet shumë nga gazetët tjera për korrektësinë dhe saktësinë dhe ka një qasje shumë interesante, përveç tjerave trajtimin dhe analizën e shumë temave nga ekonomia, kultura dhe shkencat e natyrës. Kjo gazetë mbete një shkollë që duhet ndjekur dhe studiuar.

Anketoi: Valëza Gela,
Kushtim Cerkini
dhe Halime Demiri



Petrit Ahmeti

Ka disa vite që unë jam bërë pjesë e UBT-së, fillimisht si student i nivelit Master dhe tani si pjesë e stafit Akademik. Gjatë kësaj kohe, rregullisht kam lexuar gazetën “UBT News”. Mendoj se kjo gazetë është shumë e pasur në përmbajtjen e saj, duke përfshirë të gjitha fushat e interesit të studentëve si dhe mësimdhënësve. Këtë e mbështes në publikimin e



Petrit Shala

Rregullisht e lexoj gazetën “UBT News”, gazeta nuk krijon sensacione të panevojshme. Temat



UBT DHE SOROS VAZHDOJNË BASHKËPUNIMIN

Mars 2012 - Presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), Prof. Dr. Edmond Hajrizi dhe koordinatori i Zyrës për Projekte z. Lulzim Beqiri, zhvilluan një takim të rëndësishëm me zëvendës drejtoreshën e Programit Lindje Lindje Partneritet Përtej Kufijve të Fondacionit për Shoqëri të Hapur, znj. Merril Sovner dhe znj. Vera Pula, koordinatore e Programit për Kosovën.

Në takimin që u zhvillua në objektin e SOROSIT, u bisedua për bashkëpunimin ndër-institucional, më konkretisht për realizimin e projekteve të tjera të përbashkëta.

Në këtë takim janë prezantuar rezultatet e projektit “Ngritja e Kapaciteteve për Investimet e Huaja Direkte në Kosovë”. Ky projekt u realizuar gjatë vitit të kaluar, organizator dhe implementues të projektit ishin Quality Kosova dhe Czech INVENT Technology Agency, kurse është mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Çekisë, SOROS - Zyra në Pragë dhe në Prishtinë dhe UBT.

Përfutues të projektit ishin MTI, komunat e Republikës së Kosovës dhe ARZH-të.

SHKËMBIMI I STUDENTËVE

STUDENTËT - NDËRLIDHJA MË E MIRË ME BOTËN E SHKENCËS

Nga UBT kanë dalë një numër i të diplomuarve të vendeve të tjera, si Natasha Koleva, vajza e ish-përfaqësuesit diplomatik të Bullgarisë në Kosovë, e cila ka studiuar në UBT, në Departamentin Diplomaci dhe Shkenca Politike – program në gjuhën angleze, e cila gjatë diplomimit para të pranishmëve theksoi: "UBT-ja ka si slogan që e shpjegon atë – 'Top universiteti për top studentët'"

N. DEMIRI

UBT në kuadër të programeve të shumta që ka për ecjen e saj drejt ndërkombëtarizimit, mjaft të zhvilluar e ka edhe Programin për shkëmbimin e studentëve. Programi është përpiluar në bazë të programeve të studimit që UBT paralelisht i ka zhvilluar në dy gjuhë, shqipe dhe angleze, si dhe gjuhët e tjera si gjermanisht dhe frëngjisht. Këto programe i ka organizuar duke sjellë stafin akademik të rangut më të lartë në fushat e shkencës për programet që i zhvillon, dhe në vazhdimësi bashkëpunon me universitete më prestigjioze në lëmin e shkëmbimit të studentëve dhe stafit akademik dhe administrativ, ku në saje të kësaj pune sot UBT ka ardhur në pikën ku është krenare për ndërkombëtarizimin e saj.

Nga UBT kanë dalë një numër i të diplomuarve të vendeve të tjera, si Natasha Koleva, vajza e ish-përfaqësuesit diplomatik të Bullgarisë në Kosovë, e cila ka studiuar në UBT, në Departamentin Diplomaci dhe Shkenca Politike – program në gjuhën angleze, e cila gjatë diplomimit para të pranishmëve theksoi: "UBT-ja ka si slogan që e shpjegon atë – 'Top universiteti për top studentët'".

"Sikurse që unë dua të jem top studente, kam përzgjedhur të studioj në top universitet, në UBT. Arsyja vendimtare për të përzgjedhur UBT-në është që ka partneritet me shumë universitete nga jashtë, ku do të doja të theksoja Akademinë Diplomatike të Vjenës, ku jam duke synuar që të studioj në të ardhmen e afërme. Profesorët ndërkombëtarë dhe vendorë, me përvojë të mirë, që janë duke mbajtur ligjëratat në UBT, janë gjithashtu të një rëndësie të madhe për t'i arritur qëllimet e mia", thotë ajo, e cila shton se përmes komunikimit në disa gjuhë që fliten në UBT nuk e ka pas vështirë të ambientohet me UBT-në. "Unë studioj në anglisht, si dhe kemi kurse në gjuhën frënge dhe në atë gjermane. Nuk kam asnjë vështirësi në komunikim dhe në kuptim, si me profesorët ashtu me kolegët e mi", tha ajo.

Pasi UBT njihet si institucion ndërkombëtar në vend dhe në të gjitha trevat shqipfolëse dhe më gjerë për këtë rol të madh dhe të rëndësishëm ka luajtur shkëmbimi akademik në ndërkombëtarizimin e UBT-së, duke mbajtur

ligjëratat në gjuhën angleze dhe gjuhë tjera.

Prof. Dr. Mohamed Bazaz, profesor që 20-të vite në Universitetin e Oakland-it në SHBA dhe ligjërues në Fakultetin e Menaxhmentit, Biznesit dhe Ekonomisë në UBT, thotë se "kurrikulat e edukimit të lartë në ShBA dhe Kosovë pikërisht në UBT janë relativisht të ngjashme".

UBT i vetmi universitet privat në vend që ofron studime të doktoratës jashtë vendit

Është e zakonshme që studentët kosovarë të përfshihen në projekte të ndryshme të universiteteve të huaja dhe të shfrytëzojnë mundësitë që ofron shkollimi jashtë vendit. Mirëpo, për dallim nga universitetet e tjera në vend dhe me gjerë, që kanë numër të vogël ose fare nuk kanë studentë të huaj, që studiojnë në vendin tonë, kjo dukuri në UBT nuk vërehet siç e potencuam edhe më lart nga biseda me znj. Koleva.

UBT është përfitues i projektit "Erasmus mundus", ku përfshihen 16 universitete nga rajoni dhe Evropa, prej tyre tetë nga vendet e Ballkanit. Ndryshe, UBT është universiteti i vetëm privat nga Kosova dhe rajoni që është përfituese e projektit në fjalë, i cili projekt është një kontribues i madh për katër vitet e ardhshme, siç janë bursat që ofrohen për të studiuar në vendet e Bashkimit Evropian, por edhe në rajon.

Përmes këtij projekti UBT u ka mundësuar jo vetëm studentëve të vet të kyçen për studime jashtë vendit, por edhe të universiteteve tjera kyçen në UBT. Projekti parash studimet themelore, master dhe doktoratë, si dhe një numër i madhe i studentëve të UBT vetëm janë pranuar dhe kanë fituar bursën dhe që nga fillimi i vitit të ri akademik 2011/2012 kanë filluar studime aty ku janë përcaktuar me kohë. Studentet të cilët janë përcaktuar për studime themelore janë: Në Universitetin Limerik në Irlandën janë pranuar këta studentë si Njomza Havolli, Bleritë Bytyci, Egzon Dushku, Anesa Ramaxhiu, Burim Ramadani, Rineta Jashtari, Arnisa Kryeziu, Agron Krasniqi, kurse në Universitetin City në Londër në Britani të Madhe janë pranuar këta studentë si Drilon Zenuni, Rina Sadriu, Ndriqim Idrizi, Diana Llugaxhiu, Fatlum Gerguri, Haris Haxhimehmeti, Shkurte Berisha dhe Arian Again, kurse në Universitetin Freie



të Berlinit është pranuar Qëndresa Sopjani, Erodita Llugaxhiu, Mirsad Kosumi në Universitetin e Bukureshtit në Rumani dhe Lirigzona Morina në Universitetin Lapenarta në Finlandë. Po ashtu përmes këtij projekti ka kandidatë që janë pranuar për studime të pos-doktoratës si Binak Beqaj, në Universitetin "City" në Londër etj.

Po ashtu me Universitetin "City", UBT ka marrëveshje bashkëpunimi, që u ka mundësuar studentëve kosovarë që studimet universitare në nivelin bachelor, master dhe në doktoraturë t'i ndjekin në UBT dhe në Universitetin City, po ashtu stafit akademik zhvillim e kompetencës në fushën hulumtuese dhe zhvillimore. Bashkëpunimi do të ofrojë edhe programe të tjera te veçante si; projekte, seminare, transferi i teknologjisë dhe takime të tjera akademike për çështje të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet.

UBT në vitin që lamë pas ka lidhur marrëveshje e bashkëpunim ndëruniversitar në të gjitha nivelet e studimit e sidomos në fushën e doktoratës edhe me Universitetin Parthenope, në Napoli të Republikës së Italisë.

Menaxhmenti i lartë i UBT-së, në këtë rast presidenti Prof. Dr. Edmond Hajrizi, kujdes të veçantë i ka kushtuar depërtimit të studentëve nga UBT në universitete tjera, në të gjitha programet e studimit edhe në këtë pikë ka rezultuar suksesshëm, e cila lidhet direkt me Programin shkëmbimi i studentëve dhe UBT-ja është e vet-

mja prej institucioneve të arsimit të lartë privatë që studentëve të vet ju krijon këtë mundësi të studimit të doktoratës jashtë vendit.

Sa për ilustrim po marrim si shembull disa kandidatë, të cilët kanë përfunduar një pjesë të studimeve në UBT dhe për më tutje kanë vazhduar në universitete të Evropës, në të gjitha nivelet e studimit. Dr. Binak Beqaj, i angazhuar në UBT, ka mbrojtur temën dhe mori titullin doktor nga fusha e planifikimit dhe menaxhimit urban në Universitetin Teknik (TU) të Vjenës në Austri, kurse Mimoza Dugolli, Lulzim Beqiri dhe Muhamet Ahmeti, kanë përfunduar studimet master në UBT, dhe gjatë vitit të kaluar kanë filluar studimet të doktoratës në TU.

Po ashtu nga UBT një numër i të diplomuarve në studimet themelore kanë vazhduar dhe me sukses kanë përfunduar studimet master jo vetëm në shtetet më prestigjioze në Evropë por edhe në Amerikë.

Arlinda Shaqiri dhe Leana Mamuti, studimet themelore i ka përfunduar në UBT, Departamenti Arkitekturë, kurse studimet Master në Universitetin "Politecnico Di Milano" në Itali, drejtimi Arkitekturë. Ermal Lubishtani, i ka përfunduar studimet Master në Mbretërinë e Bashkuar (UK), në Staffordshire University në Business School, Armend Merovc në Mbretërinë e Bashkuar, Ilir Hajdini, në "University of Sussex" po ashtu në Angli. Vigan Sadiku, studimet posdiplomike ka përfunduar në Suedi në Lund University, në Fakultetin Lund School of Economics, Rrezarta Veseli, ka përfunduar studimet Bachelor

në Fakultetin Shkenca Politike në UBT kurse studimet Master i ka përfunduar në ShBA, në shkollën Edward J. Bloustein për Planifikim dhe Politika Publike në Universitetin Rutgers.

Një shkëmbim mjaft të suksesshëm UBT e ka arrit edhe me anë të uorkshopeve të shumta, ku studentët e Universiteti i Innsbruckut nga Austria bashkërisht me studentët e Fakultetit të Arkitekturës në UBT bënë një vizitë njëjavore nëpër Prishtinë sidomos nëpër objekte të trashëgimisë kulturore.

Po ashtu një vizitë që vlen të theksohet është se një grup prej 25 studentëve nga Shtete e Bashkuara të Amerikës dhe tre profesorë nga Danimarka përkatësisht nga "Instituti Danez për Studime jashtë vendit", krahas aktivitetëve të tjera që zhvilluan nëpër institucionet e Kosovës si EULEX, OSBE, OJQ, etj., për vizitë akademike kanë përzgjedhur UBT dhe përcollën edhe një ligjëratë të Presidentit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizin me temën "Zhvillimet dhe ngecjet pas luftës së fundit në Kosovë".

Kurse pas një kohe studentët UBT organizuan vizitë studimore në Republikën e Italisë. Këtij organizimi iu bashkëngjiten stafi akademik dhe administrativ i UBT-së. Studentët gjatë vizitës njëjavore në Itali kanë vizituar objekte me vlera historike të periudhave të ndryshme kohore dhe me stile të ndryshme të ndërtimit, si dhe bukuritë natyrore dhe bregdetare. Ata, po kështu kanë vizituar edhe qytete të ndryshme si Riminin, Venedikun, kryeqendrën Romën,



UBT organizoi Kampionati Evropian të Futbollit për Robotë

12 robotë industrialë ishin pjesë e një ekipi futbollit që i kanë dhuruar edhe medalje Kosovës

Më 11 qershor 2009, njëzetën ndeshje, në katër kategori, me pjesëmarrje të ekipeve nga shtetet me traditë të gjatë dhe hov të madh në zhvillimin teknologjik, kanë qenë pjesë e Kampionatit Evropian të Futbollit për Robotë, që e organizoi UBT po në lokalet e UBT-së. Ishte nënkryetari i FIRA-së dhe udhëheqësi i FIRA-së për Evropë, prof. dr. Peter Kopaček, ai që ditën e fundit të kampionatit, krahas falënderimit të madh për UBT-në për mikpritjen dhe organizimin shumë të mirë të garave. Edhe presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, në cilësinë e organizatorit, u nda shumë i kënaqur me garat e organizuara, por edhe me suksesin e ekipit kosovar UBT-Kosova, që zuri vendin e tretë në dy kategori të garave, një sukses ky shumë i mirë, duke pasur parasysh nivelin e zhvillimit të teknologjisë së fundit të ekipet e tjera, ekipe me shumë më shumë traditë dhe me përkrahje të madhe.

Kur jemi tek garat dhe rezultatet, duhet të përkujtojmë se në fund, kampion në "EUROBY 2009" doli ekipi "UT Austria", në vendin e dytë ekipi nga Sllovakia, në vendin e tretë "UBT-Kosova", ndërsa në vendin e katërt Austria HTL. "EUROBY 2009" përfundoi, me përshtypjet më të mira të pjesëmarrësve ndërkombëtarë, si për UBT-në ashtu edhe për kryeqytetin, për Kosovën.

Pjesëmarrës në kampionat, që e përcollën atë në objektin e UBT-së, u shprehën të ngazëllyer me atë që po shihnin, si dhe për faktin se UBT është i pari universitet në vend dhe në rajon që organizon një ngjarje kaq të rëndësishme të karakterit ndërkombëtar.

"Billy është roboti më korpulent që ka Kosova. Ju në UBT e njihni, sepse e krijuat vet dhe strehë i bëtë kabinetin tuaj të Robotikës. Dhe, s'është i vetmi që e keni. Nga të tjera krijesa inteligjente që nuk frymojnë keni edhe një robot humanoid, robotë industrialë dhe janë 12 të tjerë, pjesë e një ekipi futbollit që i kanë dhuruar edhe medalje Kosovës", u shpreh gazetari Besnik Krasniqi.

Ndërsa gazetari Moral Pozhegu theksoi: "Aq shumë ka përparuar teknologjia, fatmirësisht edhe në vendin tonë, falë UBT-së, sa që ishte kënaqësi dhe e habitshme t'i shohësh robotët duke luajtur futboll, sigurisht të dirigjuar nga njerëzit, që u rrinin mbi 'kokë'. Shumë skuadra evropiane morën pjesë në këtë event, i cili është i rrallë dhe i paparë ndonjëherë në Kosovë".



Shumë konferenca ndërkombëtare e videokonferenca

UBT e vetmja në vend që ka organizuar për tetë herë me radhë Videokonferenca me karakter shkencorë në bashkëpunim Universitetit Bunkyo-Tokio, Japoni.

Po ashtu UBT, prej themelimit të saj ka organizuar një varg konferencash në nivel ndërkombëtar. Të themi se vetëm në konferencën "Gjeta e rrugëve shtesë për stabilitetin ndërkombëtar" morën pjesë mbi 100 shkencëtarë nga të gjitha kontinentet e botës, të cilët paraqitën hulumtimet e tyre shkencore.

"UBT Kosova-Robots" fitoi kupën e Evropës

Në maj 2011, për tre ditë rresht, në UBT, në Prishtinë, u zhvillua Gara Evropiane e Robotëve që luajnë futboll "EUROBY 2011", dhe më 6 maj 2011 u zhvillua edhe ndeshja finale. Në finale u takuan "UBT Kosova-Robots", që e përfaqësoi Kosovën, dhe ekipi "Austro" përfaqësues për Austrinë. "UBT Kosova-Robots" e mposhti ekipin mysafirë "Austro" me rezultat 3:2, dhe ekipi kosovar u shpallur fitues i Evropës në Futbollin për Robotë. Kjo ndeshje është zhvilluar në të ashtuquajturën ligë e madhe ose "EX tendet middle".

Firencen, vizituan edhe kompani të ndryshme biznesore dhe ndërtimore.

Lulzim Beqiri, ish-student dhe i angazhuar në menaxhim dhe në mësimdhënie në UBT gjatë dy viteve të fundit ka bërë disa vizita nëpër vende të ndryshme si në Salzburg të Austrisë dhe në Universitetin e Bukureshtit në Rumani. Qëllimi i vizitës ka qenë njohja me strukturën organizative të Universitetit të Salzburgut në aspektin akademik dhe administrativ, me fokus të veçantë në Zyrën për sigurimin e cilësisë.

Vizitë organizuan edhe ekipi i futbollit për robotë, "Skenderbeu" i UBT-së në Universitetin e Cassino-s, në Itali, në Institutin

e Mekatronikës dhe Robotikës, dhe ky ekipi i profesorëve dhe studentëve i udhëhequr nga rektori i UBT-së, Dr. Edmond Hajrizi, u prit nga shefi i këtij Instituti, Dr. Marco Caccarrelli dhe profesor të tjerë, bashkë me të cilët u realizuan vizita në laboratorët e mekatronikës dhe robotikës.

"UBT kërkimet shkencore i ka botuar në revista të universiteteve partnere ndërkombëtare, dhe tash tutje kërkimet ne do i orientojmë në revistën që e kemi brenda universitetit ku UBT me të drejtat e plota dhe i vetmi në Kosovë si nga institucionet publike po ashtu edhe private ka fituar Numrin Serik Ndërkombëtar të Librit (ISSN)", tha Prof. Dr. Edmond Hajrizi, President i UBT-së.

PJESËMARRJA E DR. HAJRIZIT NË PANAIRIN CEBIT U SPONSORUA NGA KOMISIONI EVROPIAN DHE PROGRAMI PËR HULUMTIM FP7

Mars 2012 - Presidenti i Universiteti për Biznes dhe Teknologji, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, i sponsoruar nga Komisioni Evropian, dhe me ftesë të projektit evropian Seventh Framework Programme (FP7), me qëllim të ngritjeve të kapaciteteve në fushën e hulumtimeve në Kosovë, edhe ngjitjes së rrjetit bashkëpunim ndërkombëtar, për katër ditë më radhë ka qëndruar në Hanover të Gjermanisë ku ka marrë në forumin "Future Match", i cili forum u zhvillua në kuadër të Panairit për Teknologji dhe Informacion CEBIT.

Gjatë pjesëmarrjen në panair, dr. Hajrizi ka zhvilluar edhe një varg takimesh me bartës të institucioneve të rëndësishme hulumtuese nga shumë vendet, si Polonia, Austria, Italia Gjermania, Greqia, Brazili, Spanja, etj., me të cilët ka diskutuar për bashkëpunim ndërinstitucional në një të ardhme të afërt. Në takim ishin të pranishëm rreth 250 pjesëmarrës.



UBT PËRFITUES I PROJEKTIT NORVEGJEZ AEP PËR ICT



Mars 2012 - Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) këtë vit dhe për tre vitet e ardhshme është përfitues i projektit Academic Exchange for Progress (AEP), i financuar nga Qeveria Norvegjeze, dhe nga ky projekt përfiton stafi akademik dhe studentët e UBT, në të gjitha nivelet e studimit.

Partneri akademik nga Norvegjia është Gjøvik University College. Ky projekt ka për qëllim avancimin në fushën e teknologjisë së inoformacionit dhe komunikimit në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni.

Përveç UBT-së, në kuadër të këtij përfshihen edhe disa universitete nga rajoni, si Universiteti i Tiranës, Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë dhe Universiteti i Prishtinës.

Vlen të theksohet se UBT është universiteti i vetëm privat nga Kosova dhe rajoni që është përfitues nga ky projekt. Partner tjerë të involvuar në projekt janë: STIIK, AITA, Crimson Capital s.r.o, Athene Kosova dhe Athene Prosjektledelse.

DR. HAJRIZI - RESEARCH FOLLOW NË UNIVERSITETIN CITY



Mars 2012 - Presidenti i Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT), Prof. Dr. Edmond Hajrizi, në kuadër të qëndrimit të tij në Britani të Madhe përveç që është duke zhvilluar aktivitetet hulumtuese dhe akademike në Universitetin City në Londër si Research Follow, po zhvillon takime të ndryshme të karakterit hulumtues, shkencor në Universitetin City, Universitetin Queen Mary, në Oxford, në Cambridge e institucione të tjera me renome në Britaninë e Madhe.

Përgjatë qëndrimit të tij në City, Dr. Edmond Hajrizi është fokusuar në studimin që kanë të bëjnë me dizajnimin dhe Menaxhimi i sistemeve komplekse ku janë të lidhura përveç aspekteve teknologjike edhe aspektet, ekonomike dhe sociale.



DR. HAJRIZI U TAKUA ME STUDENTËT E UBT NË UNIVERSITETIN CITY

Mars 2012 - Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, në kuadër të qëndrimit të tij në Britani të Madhe përveç tjerave ka takuar edhe studentët e UBT-së, të cilët janë përfitues të bursës përmes projektit "Erasmus Mundus".

MR. JESSIE L. MASSEY

DISKUTOI ME STUDENTËT E UBT-së

Prishtinë, 26 prill 2012- Ekspert i Logjistikës nga USA, Mr Jessie L. Massey, ka marr pjesë në debatin e organizuar në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), në temën "Menaxhimi i zinxhirit të furnizimit".

Të pranishëm në debat ishin profesorë të UBT-së, studentë dhe të interesuar të tjerë, të cilët përcollën me interesim debatin.

Ligjërata ka qenë e orientuar në përfshirjen e integritimit të informacionit, transporti, inventari, trajtimin e materialit, paketimin dhe sigurinë si dhe në kompleksitetin e logjistikës së prodhimit dhe të modelimit përmes ndihmës së softwereve, e cila është vazhdimisht e ndikuar nga ndryshimet ndërkombëtare.

Gjithashtu përqendrimi i ligjëratës ka qenë edhe në shtjellimin e menaxhimit të zinxhirit të furnizimit kundrejt logjistikës, për furnizimin dhe zinxhiri e kërkesave, trendit të vlerave, ndërkombëtare të furnizimit, transporti dhe pjesëmarrësit në transport, pesë modelet themelore të transportit dhe kostoja e strukturës për çdo model transporti.

Në fund të debatit, Presidenti i UBT-së, Dr. Edmond Hajrizi në kabinetin e tij po në objektin e Universitetit, zhvilloi një bisedë me mysafirët dhe i njoftoi me punën dhe organizimin e UBT-së, si dhe i falënderoi ata për pjesëmarrje në debat në UBT.



UBT BASHKËPUNON NGUSHTË ME MASHT-in

Prishtinë 15-16 maj 2012- Në kuadër të konferencës vjetore "Java e Shkencës" që e organizoi Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht Departamenti i Shkencës, për katër ditë me radhë, në 11 sesione shkencore, në tetë fusha të ndryshme të hulumtimit u kumtuan 193 punime shkencore dhe u paraqitën 350 autorë nga vendet e rajonit dhe Austria.

Me kumtesa mjaft voluminoze u paraqitën, edhe në këtë vit profesorë e ligjërues të UBT-së si Prof. Dr. Hamit Mehmeti, Dr. sc. Binak Beqaj dhe Msc. Xhemajl Mehmeti.

Prof. Dr. Hamit Mehmeti, në vend të Presidentit të UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, e krye-

soi seancën "Shkenca teknike, inovacioni dhe transferi i teknologjisë" dhe u paraqite me një punimin shkencor "Anizotropia e vetive mekanike e çelikut të petëzuar në të nxehtë" me këta bashkautorë: Rrahim Maksuti, Hamit Mehmeti, Mursel Rama, Malush Mjaku.

Në këtë punim është shqyrtuar anizotropia e vetive mekanike të çelikut të petëzuar në të nxehtë (S235 EN 10025:2004) të mbështjellë në lëmsa (bobina), që përdoren për prodhimin e gypave të salduar, nëpërmjet përcaktimit eksperimental të vetive mekanike dhe analizës metalografike.

Dr. sc. Binak Beqaj, prezantoi punimin shkencorë me titull "Planifikimi urban dhe infrastruktura e trafikut në Prishtinë".

"Edhe pse janë zhvilluar disa iniciativa në Prishtinë, për aplikimin e përvojave të ndryshme nga vendet e zhvilluara, në lidhje me zgjidhjen e problemeve të trafikut urban përmes Planit Strategjik të zhvillimit të Prishtinës, implementimi i tyre nuk ka ndodhur dmth si rrjedhojë e kësaj por edhe për shkak të rritjes rapide urbane (migrimi i popullsisë nga zonat tjera të Kosovës për në Prishtinë) dhe Prishtina si zonë urbane nuk është në gjendje të plotësoj nevojat për një rrjet më të zhvilluar të trafikut", cekti Dr. Beqaj.

Ai me tutje shtoi se kërkesat në lidhje me këto elemente urbane nuk janë adresuar në mënyrë adekuate përmes koncepteve planifikuese zhvillimore si dhe prioriteteve investuese, kështu që situata e tanishme rreth infrastrukturës së trafikut paraqitet e komplikuar dhe pa ndonjë perspektivë të qartë zhvillimore derisa politik-bërësit, profesionistët dhe shoqëria civile nuk i bëjnë gjerat e duhura në mënyrë të koordinuar, përfundoi Dr. sc. Binak Beqaj.

Mr. Xhemajl Mehmeti me bashkautor si Prof. Dr. Naser Lajqi dhe Mr. Sc. Shpejtim Lajqi, u paraqitën me punimin shkencorë "Zhvillimi i modelit të funksionimit të mirëmbajtjes së automjeteve që ngasen në Republikën e Kosovës". Qëllimi i këtij punimi është krijimi i modelit të organizimit të funksionimit të mirëmbajtjes së automjeteve që ngasen në Republikën e Kosovës, e cili do të ndikon në rritjen e kapacitetit punues të tyre dhe rritjen e efikasitetit të tyre. Pra objektivi është që të bëhet një model i ri i funksionimit të mirëmbajtjes së automjeteve i bazuar në kushtet



klimatike, nivelin e ndotjes së ambientit, kushtet infrastrukturore, shpejtësinë mesatar të ngasjes së automjeteve, etj. Gjithashtu do të paraqitet vjetërsi e automjeteve që ngasen në Republikën e Kosovës, gjendja aktuale e ndërrimit të filtrave vajit, ajrit dhe lëndës djegëse si dhe do të jepen rekomandime për kohën e ndërrimit të tyre në funksion të një jetëgjatësi më të madhe të sistemeve të automjetit.

Modeli i paraqitur në këtë punim mund të përdoret nga ngasësit automjeteve dhe nga kompanitë që merren me mirëmbajtjen e automjeteve në Republikën e Kosovës.

Ministri Buja: MASHT është i përkushtuar për zhvillimin e shkencës në Kosovë

Ministri i arsimit, Ramë Buja me rastin e hapjes së punimeve të kësaj konference, ndër tjera tha se MASHT mbetet e përkushtuar që të nxisë zhvillimin e shkencës në Kosovë dhe shtoi se kjo gjë nuk ishte në nivelin e dëshirueshëm për shkak të prioriteteve investuese emergjente në përmirësimin e infrastrukturës shkollore. Ministri gjithashtu theksoi se

mundësitë nuk janë të mjaftueshme përkundër dëshirës dhe kapaciteteve shkencore që kanë shkencëtarët tanë por jemi afër rendit për të menduar seriozisht për zhvillimin e shkencës në të ardhmen. «Angazhimet e MASHT-it nuk kanë munguar dhe nuk do të mungojnë në të ardhmen por tash jemi duke punuar të krijojmë një infrastrukturë kadrovike të mirëfilltë shkencore për të qenë aty ku duhet në nivelin organizativ në radhë të parë» tha ministri Buja.

Kontributi i UBT-së në 2010,

Presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), Prof. Dr. Edmond Hajrizi, në konferencën në fjalë, e cila është mbajtur në 2010, patë folur rreth arritjeve të UBT-së në aspektin shkencor, duke shtuar se përmes UBT Kosova sot është e anëtarësuar në shumë organizma më të mëdha botërore në Organizatën Ndërkombëtare për Cilësi (OEC), në Federatën Ndërkombëtare të Kontrollit Automatik (IFAC), si dhe në Organizatën për Menaxhimi i Projekteve (IPMA). Po ashtu në UBT është mbajtur Kampioni "Euroby 2009", dhe Kosovën e ka përfaqësuar UBT-ja.

PRESIDENTI I UBT-së MORI PJESË NË KONFERENCËN SHKENCORE PËR MODELIM DHE SIMULIM NË VJENË



Mars 2012 - Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi ka marrë pjesë në konferencën shkencore ndërkombëtare për modelim dhe simulim (MATH-MOD) në Vjenë të Austrisë. Në konferencë kanë marrë pjesë një numër i madh shkencëtarësh nga mbarë bota.

z. Hajrizi, përveç kontributit që ka dhënë në konferencë, do të marrë pjesë edhe në procesin e vlerësimit të punimeve shkencore të paraqitura në konferencë, të cilat do të publikohen në revista profesionale ndërkombëtare.

NEW TASTE MAX ENERGY



magnum

ENERGY DRINK
PIJE ENERGIJE

Produkt nga WILD Germany



SEMINAR PËR STIRIPORIN

Prishtinë, 4 maj 2012 - Studentët si Merita Jashari-Hoxha, Gention Maliqi dhe Filloreta Hasani realizuan dhe prezantuan seminarin me temën "Stiropori", në lëndën "Temat specifike nga menaxhmenti", te prof. dr. Hamit Mehmeti.

Përveç tjerave, studentët treguan talentin e tyre duke pre-

zantuar edhe një punim dorë - llogon e UBT-së, po ashtu kanë sjellë edhe disa produkte që bëhen pas rishikimit të stiroporit, dhe i demonstrieran gjatë prezantimit të seminarit. Të pranishëm, përveç profesorit të lëndës ishin edhe të gjithë studentët e departamentit në fjalë si dhe mysafir tjerë.



RRËMBEU ÇMIMIN E PARË

Prishtinë 14 maj 2012- Lirigzona Morina, përveç studimeve nuk ka të ndalur së vazhduari edhe aktivitete tjera, ku sot është paraqitur në shoun "Skina-vision Singing Context" në Finlandë, me këngën "Someone like you", të këngëtares britanike Adele.

Prej konkurrencës mjaft të gjerë, juria profesionale bëri publike, dhe vendin e parë e rrëmbeu Lirigzona Morina. Po ashtu znj. Morina, para disa dite në shoun "Talenti multikulturor", ka rrëmbyer çmimin e tretë.

Lirigzona Morina, është studente e UBT-së, e cila ka fituar bursë për vazhdimin e studimeve përmes projektit "Erasmus Mundus", përmes UBT-së, në Universitetin Lappeenranta të Finlandës.

ARBËRI NË FINALE

Konkurenti nga Kosova në Big Brother Albania 5, Arbër Zeka, i cili studimet themelore i ka përfunduar me sukses në Universitetin UBT, në gjuhën angleze, në Prishtinë, gjatë këtyre ditëve ka arritur që të jetë konkurenti i parë nga Kosova që debuton në një finale të këtij spektakli.



RRËMBYYESI I MEDALJEVE



HEROLIND DRESHAJ

Sportisti i famshëm i karatesë Herolind Nishevci, po ashtu student në Universitetin UBT, në çdo turne që ka marr pjesë thuajse ka zënë vendin e parë, jo vetëm në nivel lokal por edhe atë ndërkombëtar nëpër shtetet më të zhvilluara të Evropës dhe botës. Edhe në këtë vit Herolindi ka korrur suksese të shumta duke i rrëmbyer medaljet e çmimet më të larta.

Më konkretisht fiton medaljen e argjend për Kampionatin botëror në Stamboll të Turqisë, më pas fiton vendin e parë edhe në turneun "Swiss open", në Zvicër, po ashtu vendin e parë e merr edhe në "Ozawa cup", Las Vegas në ShBA.

Herolindi është duke u përgatitur për sezonet e ardhshme për këto turnire si në Austri në turnirin "Austrian Junior Cup", po ashtu do marr pjesë edhe në turnirin "Greece Open" në Greqi, po ashtu edhe në Gjermani.

Më herë ka rrëmbyer këto vende si në Las Vegas (Ozaëa Cup, po ashtu edhe Usa Olympics junior Open), në Tokyo, në Qipro në Chicago Open, në Atlanta Cup, dhe vendin e parë në Australia junior Open, kurse vendin e tretë në Istanbul Open, dhe shumë vende të para në shtetet ballkanike si në Bosnjë, Shqipëri, Mal të Zi, por rezultati më i rëndësishëm është kur merrte vendin e parë në Mesdhe me Kombëtaren e Shqipërisë.

ARAGONA BAND ME KLIP TË RI



HEROLIND DRESHAJ

Grupi "Aragona Band" pas gjashtë viteve me muzikë live nëpër Kosovë e nëpër trevat shqiptare më në fund lansuan klipin e parë me titull "Vajza anonime"

Kënga është punuar te Florent Boshnjaku, spoti u realizua te "Asha production".

Kënga ka pas mjaft sukses nëpër top listat e ndryshme kosovare si "Top koha", e shumë emisione tjera ...

Po ashtu ky grup së shpejti pritet ta publikoj edhe një klip të ri në bashkëpunimi me këngëtares Rozana Radi. Kënga është punuar te "Kico Beatz" - Arian Haxhixhemajli, poashtu student i UBT-së. Spoti pritet të del për brenda muajit maj.

DY FEMRA DO T'I PRISTE ALBATRITI ME VITE



Djali i këngëtarit të mirënjohur kosovar, Nysret Muçiqi, Albatrit Muçiqi, cili është studentë në Fakultetin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në Universitetin UBT, këto ditë ka lansuar klipin e këngës "Sa vite", i ftuar në programin "Top Kosova Radios", ka thënë se janë vetëm dy femra të cilat ai do t'i priste shumë vite.

Bëhet fjalë për divat e famshme botërore, Beyonce dhe Rihanna, të cilat Albatriti do t'i priste me vite, vetëm e vetëm të bënte bashkëpunim me to.

Po ashtu, Albatriti ka treguar se nga miqtë e tij ka marrë kritika pozitive për këngën më të re. Po ashtu i

Ai gjithashtu ka pohuar se në fillim të vitit do të publikojë albumin e tij, të cilin është duke e përgatitur me kantautorin Flori Mumajesi. **Lajmonline**

Top University Education for Top Students



10 vite Lider i Arsimit të Lartë

I certifikuar sipas Standardit ISO 9001 për cilësi

Përfytyes nga Kosova i Programit Evropian ERASMUS MUNDUS

Përfaqëson Kosovën në Organizata Evropiane dhe Botërore

Kampion Evropian në Robotikë 2011

*Zgjedh më të mirin ...
... që të bëhesh më i miri!*

- PROGRAMET E AKREDITUARA

- MENAXHMENT, BIZNES DHE EKONOMI (BA, MA)

Me mundësi specializimi:

- Financa, Banka dhe Kontabilitet,
- Marketing dhe Shitje,
- Manaxhment dhe Ndërrmarrësi (MA)

- SHKENCA KOMPJUTERIKE DHE INXHINIERI (BSc, MSc)

Me mundësi specializimi:

- Rrjeta dhe Telekomunikacion
- Softuer dhe Sisteme Inxhinierie,
- Baza e të Dhënave dhe Sistemet e Informacionit
- Dizajn dhe Multimedia
- Mekatronikë dhe Robotikë

- MENAXHMENT I MEKATRONIKËS (BSc, MSc)

(Elektroteknika, Elektronika, Teknologjia e Informacionit, Prodhimtaria Industriale, Dizajni Industrial, Ndërrmarrësi dhe Menaxhment)

- ARKITEKTURË (BSc)

(I vetmi privat i akredituar në vend)

- JURIDIK (LLB)

(Civile, Penale dhe Ndërkombëtare)

- SISTEMET INFORMATIVE (BSc)

(Menaxhment, Biznes dhe Informatikë)

- PROGRAMET NË PROCES TË AKREDITIMIT

Ndërtimtari me Infrastrukturë (BSc)
Kommunikim, Multimedia dhe Gazetari (BA)
Studimet Evropiane dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare (BA)
Studime Britanike dhe Amerikane (BA)

Përmes UBT-së ju mund të studioni

dhe të përfitoni bursa studimi në Universitetet partnere si:



City University London, Angli



Danube University Krems, Austri
Master in Business Administration (MBA)



CIFE (Centre International de Formation Europ.), Francë
Master in European Integration and Law (MA)



WIT (Waterford Institute of Technology), Irlandë
Master in Information Systems (MSc.)

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

Diploma, dëftesat e notave, certifikata e lindjes, kopja e letërnjoftimit dhe dy fotografi 4X6

Gjuha e studimeve: Gjuha Shqipe dhe Gjuha Angleze

Mënyra e studimit:

UBT organizon ligjërata të rregullta gjatë ditës.
Për të punësuarit ofrohen ligjërata pas orarit të punës dhe gjatë fundjavës

Që suktesi juaj të jetë i garantuar, UBT ofron për secilin studentë:

- Orientim profesional, kurse përgatitore, praktika profesionale, vizita studimore dhe certifikime ndërkombëtare
- Nga një kompjuter gjatë studimeve dhe sistem online
- Praktika dhe Eksperimente në Laboratorët bashkëkohorë
- Trajtime: CISCO, Microsoft, AutoCad, ECDL, Project, etc.

Financat dhe pagesat:

- Çmimi i studimeve për një vit akademik është **1200 €**, me mundësi pagese deri në **12 këste**.

Për të gjithë nxënësit e dalluar UBT ofron zbritje 20-50%

UBT ofron zbritje deri në 30% edhe për këto kategori:

- Të punësuarit në Doganat e Kosovës
- Pjesëtarët e FSK-së dhe Policisë së Kosovës
- Të punësuarit në Institucionet Publike të Kosovës
- Familjarët e dëshmorëve dhe veteranëve të luftës
- Studentët që vijnë nga e njëjta familje dhe si grup
- Studentët që paguajnë në fillim të vitit akademik

**NUK ËSHTË
VETËM DIPLOMË...**



... ËSHTË PRESTIGJI!

... ËSHTË SUKSESI!

... ËSHTË CILËSI!

**American European
Education**

Lagjja Kalabria p.n., Prishtinë, Tel:038541400, email:info@ubt-uni.net, Koha e regjistrimit çdo ditë prej orës 9 deri në 17.

Apliko online: www.ubt-uni.net